



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 716 Akti

Nr. 780 Vendimi
Tiranë, më 3.7.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 1.7.2024, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0 (*underground*), salla B, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Rajmonda Berisha (Kopaçi)**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, komisioneren Alma Faskaj, subjektin e rivlerësimit Rajmonda Berisha (Kopaçi), vëzhguesin ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, dhe pasi shqyrtoi në seancën dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Rajmonda Berisha (Kopaçi), e cila kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rajmonda Berisha (Kopaçi), aktualisht me detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, është subjekt i rivlerësimit që i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ushtronte detyrën e prokurores.

2. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020 në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisioneret Pamela Qirko, Alma Faskaj dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Alma Faskaj.

3. Me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Rajmonda Berisha (Kopaçi), caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Xhensila Pine dhe u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jacobs.

4. Me *email*-in datë 7.1.2021, Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për fillimin e hetimit administrativ.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) është administruar raporti i hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI).

6. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit është zhvilluar mbi një hetim administrativ të thelluar me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, me vendimin nr. 2, datë 11.6.2024, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Rajmonda Berisha (Kopaçi), bazuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë, si dhe njoftimin e saj për t’u njohur me rezultatet e hetimit, materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua me *email*-in e datës 11.6.2024 me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, me të drejtën e saj për të paraqitur brenda datës 25.6.2024 pretendime/sqarime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

9. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka dërguar nëpërmjet *email*-it datë 25.6.2024 prapësimet dhe provat pranë Komisionit në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni për kriterin e pasurisë, si dhe kërkesën datë 25.6.2024, ku ka kërkuar riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera të vlerësimit (figurën dhe aftësitë profesionale).

10. Komisioni me vendimin datë 27.6.2024 ka vendosur mospranimin e kërkesës për riçeljen e hetimit, me argumentin se deri në këtë fazë nuk ekzistojnë shkaqe për riçelje të hetimit administrativ.

11. Komisioni, bazuar në vendimin nr. 3, datë 27.6.2024, nëpërmjet postës elektronike, në datën 27.6.2024 njoftoi subjektin e rivlerësimit se deri në këtë fazë të hetimit nuk e pranoi kërkesën e saj për riçeljen e hetimit, vendim i cili do të vlerësohet pas seancës dëgjimore.

12. Me *email*-in datë 27.6.2024 Komisioni i njoftoi subjektin ftesën për seancën dëgjimore të datës 1.7.2024 (ora 10:00), e cila me kërkesën e datës 1.7.2024 të përfaqësuesit ligjor të subjektit u zhvillua në orën 13:00.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 1.7.2024 (ora 13:00) në sallën e konferencave, Pallati i Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

14. Në këtë seancë, ku subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe me përfaqësuesin e saj ligjor, z. Fatmir Lushi, në përfundim kërkoi riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera të vlerësimit dhe konfirmimin e saj në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Znj. Rajmonda Berisha (Kopaçi) ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova e shpjegime kur janë nevojitur.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

16. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet e rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

17. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Rajmonda Berisha (Kopaçi), bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç dhe D të Aneksit të saj, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin një kriter vlerësimi: vlerësimin e pasurisë.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

18. ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe në përfundim ka hartuar dhe dërguar në Komision raportin përkatës¹ ku, bazuar në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

19. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacionet e marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i janë njoftuar rezultatet e hetimit mbi asetet e deklaruarat prej saj në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet e rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitin 2004 dhe vitet 2009 – 2016; (ç) provat shkrese/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore; (e) deklaratimet në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

21. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesit.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruarat në deklaratën e pasurisë *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

22. Apartament banimi me sip. 81 m², ndodhur në lagjen “**”, pallati ***, Elbasan, blerë në datën 5.3.1996, me kontratë shitje nr. ***. Vlera: 1,800,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga shitja e apartamentit 1+1, i ndodhur në lagjen “****”, Elbasan, sipas**

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.3.2018, dërgohet nga ILDKPKI-ja akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Rajmonda Berisha (Kopaçi).

kontratës nr. *** rep., datë 6.3.1996, në vlerën 800,000 lekë, si dhe kredia e marrë pranë BTA-së në shumën 500,000 lekë, në datën 12.3.1996, kredi kjo e mbyllur në tetor të vitit 2005 pranë ATK-së (Agjencia e Trajtimit të Kredive, Elbasan). Kjo pasuri është deklaruar edhe nga bashkëshorti i subjektit)².

Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

22.1 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri për herë të parë në DIPP-në e vitit 2003: *“Shlyerje kredie mujore me ATK-në në vlerën 6,000 lekë/muaj. Arsyeja e krijimit të këtij detyrimi: Marrë kredi për blerje shtëpie banimi në shumën 500,000 lekë, në vitin 1996, me afat shlyerjeje 10 vjet” dhe “Detyrim në vlerën 78,000 lekë ndaj ATK-së për blerje shtëpie në vlerën 500,000 lekë, nga e cila kam shlyer 422,000 lekë, e marrë në vitin 1996, shlyer gjatë viteve”*. Në DIPP-në e vitit 2005 ka deklaruar: *“Shlyer kredia bankare e marrë nga ATK-ja në vitin 1996 për blerjen e shtëpisë në tetor, viti 2005. Vlera e shtëpisë së blerë në vitin 1996, në shumën 1,800,000 lekë. Pjesa që zotëron 25% (në bashkëpronësi me pjesëtarët e tjerë të familjes)”*. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2006 deklaroi: *“Detyrim ndaj ATK-së kredi (blerje shtëpie) në vitin 1996, në vlerën 500,000 lekë. Shuma e detyrimit të pashlyer deri në datën 31 dhjetor është 78,000 lekë”*.

22.2 Nga hetimi ka rezultuar se ASHK Drejtoria Vendore Elbasan³ konfirmon se shtetasit Rajmonda dhe P.B janë bashkëpronarë të pasurisë nr. *** , të llojit apartament, me sip. 81 m², objekt vlerësimi, të cilin e kanë blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** , datë 5.3.21996. Subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur bashkëpronësi mbi pasurinë nr. *** , të llojit apartament me sip. 47.88 m², i regjistruar në z. k. *** , vol. *** , fq. *** , në lagjen “****”, Elbasan, apartament që me kontratë shitblerjeje nr. *** , datë 14.7.1993, e kanë blerë nga Ndërmarrja Komunale e Banesave kundrejt vlerës 15,800 lekë dhe më pas e kanë shitur me kontratën nr. *** , datë 6.3.1996, tek blerësit M e B.D kundrejt vlerës 800,000 lekë, e paguar jashtë zyrës noteriale.

22.3 Në lidhje me pagesën e vlerës së apartamentit me sip. 81 m², në pyetësin nr. 2⁴ subjekti ka shpjeguar se e ka paguar në datën 5.3.1996 sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.3.1996. Referuar informacionit dhe dokumentacionit nga ASHK Drejtoria Vendore Elbasan⁵, rezulton e provuar se regjistrimi i kontratës nr. *** , datë 6.3.1996, së shitjes së apartamentit me sip. 47.88 m², është kryer nga shtetasit Rajmonda e P.B në vitin 1996 dhe se ASHK-ja nuk ka të

² (i) Vërtetim datë 11.1.2017 nga ZVRPP-ja Elbasan, që konfirmon pronësinë e shtetasve P dhe Rajmonda Berisha mbi apartamentin nr. *** , me sip. 81 m², shk. *** , kati *** , pallati nr. *** , lagjia “****”, z. k. *** , vol. *** , fq. 155, Elbasan; (ii) kontratë shitblerjeje nr. *** rep., 1126 kol., datë 5.3.1996, ku shtetasit P dhe Rajmonda Berisha blejnë nga bashkëpronarët D (L, XH, L, M dhe M) këtë apartament me vlerën 1,800,000 lekë, e paguar jashtë zyrës noteriale; (iii) kontratë shitblerjeje nr. *** rep., *** kol., datë 6.3.1996, ku shtetasit P dhe Rajmonda Berisha shesin në vlerën 800,000 lekë, të paguar jashtë zyrës noteriale, apartamentin nr. *** , që ishte në pronësi të tyre në pallatin nr. *** , lagjia “****”, Elbasan, e vërtetuar me vërtetim pronësie datë 16.7.1993; (iv) plan i amortizimit të kredisë që ka marrë shtetasja Rajmonda Berisha në shumën 500,000 lekë, në datën 12.3.1996, me afat 120 muaj dhe plan amortizimi i kredisë, me datë rillogaritjeje 30.6.1996; (v) vërtetim nr. *** nga BKT-ja, dega Elbasan, që konfirmon se znj. Rajmonda Berisha nuk ka detyrime pranë kësaj banke në datën 5.3.1996; (vi) mandatarkëtim datë 11.3.1996 nga Banka e Kursimeve, me përshkrimin “Vlera 1,300,000 lekë, për plotësimin e shumës së kontratës nr. *** , datë 5.3.1996, për blerje shtëpie”; (vii) vërtetim nr. *** prot., datë 5.3.1996, nga Banka Tregtare Agrare (BTA), që konfirmon se znj. Rajmonda Berisha nuk është debitore pranë kësaj banke.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021, të ASHK-së Drejtoria Vendore Elbasan.

⁴ Përgjigjja nr. 5 e pyetësit nr. 2.

⁵ Përgjigjja nr. 6 e pyetësit nr. 2 (bashkëlidhur përgjigjes, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 7.5.2024, të ASHK Drejtoria Rajonale Elbasan).

arkivuar kopje të mandatit të tatimit për tjetërsimin e pasurisë. Rezulton se regjistrimi është kryer në muajin mars të vitit 1996, në kohën kur ka qenë në fuqi ligji nr. 7786, datë 27.1.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, i cili nuk i parashikonte të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme si të ardhur të tatueshme⁶. Pra, në datën e shitjes së apartamentit me vlerë 800,000 lekë, subjekti nuk kishte detyrimin për të paguar tatim.

22.4 Referuar çmimit të EKB-së⁷, rezultoi se subjekti e ka blerë apartamentin me sip. 81 m² me çmim më të lartë sesa çmimi i referencës, prandaj nuk ngrihen dyshime për favorizim të subjektit në çmimin e blerjes së apartamentit.

22.5 Nga hetimi u ngritën dyshime për shkak të mospërputhjeve të konstatuara midis deklaratës *Vetting* se “kredia për blerjen e ap. 81 m² është mbyllur në tetor 2005 pranë ATK Elbasan”, si dhe deklaratimit në DIPP-në e vitit 2006 se “shuma e detyrimit të pashlyer deri në datën 31 dhjetor është 78,000 lekë”. Subjekti ka depozituar gjatë hetimit⁸ shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2024, me dokumentacionin bashkëlidhur nga Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë, duke provuar gjithë praktikën e marrjes së kredisë në shumën 500,000 lekë dhe shlyerjen e saj deri në vitin 2005.

Lidhur me burimin e krijimit të deklaruar nga subjekti

22.6 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për këtë apartament: (i) të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm me sip. 47.88 m², në datën 6.3.1996, në vlerën 800,000 lekë; (ii) kredi në vlerën 500,000, marrë në BTA, ndërsa në pyetësonin standard subjekti ka deklaruar si burim krijimi të apartamentit me sip. 81 m² edhe “...Kursime nga paga ime dhe e bashkëshortit 500,000 lekë. Mënyra e pagimit u bë në cash”.

22.7 Në lidhje me të ardhurat nga shitja e apartamentit në vlerën 800,000 lekë, sipas trajtimit në pikat 22.2 dhe 22.3 më lart, këto të ardhura u konsideruan si të ligjshme nga Komisioni dhe, si të tilla, janë burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit me sip. 81 m², objekt vlerësimi. Përfitimi i këtyre të ardhurave provohet me kontratën e shitjes.

22.8 Në lidhje me të ardhurat nga kredia e marrë në Bankën Tregtare Agrare, në vlerën 500,000 lekë, me afat 10 vjet dhe me normë interesi 7%, nga plani i amortizimit të kredisë rezulton se disbursimi i saj është bërë në datën 12.3.1996 dhe pas pagesës së 3 kësteve të para është bërë një ndryshim i normës së interesit nga 7% në 8%, pa ndryshuar kushtet e tjera. Në pyetësonin nr. 3⁹, subjekti ka shpjeguar se kredia është marrë në emrin e saj në vlerën 500,000 lekë në Bankën Tregtare Agrare, në datën 12.3.1996, me afat 120 muaj, si dhe ka provuar me dokumentacion ligjor përfitimin e kredisë, destinacionin dhe shlyerjen e saj. Subjekti ka depozituar informacionin dhe dokumentacionin e marrë nga Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyerë¹⁰, sipas të cilit me vendimin nr. ***, datë 11.3.1996, Banka e Kursimeve ka miratuar dhënien e

⁶ Kjo e ardhur është njohur si një e ardhur e tatueshme me Dekretin nr. 1673, datë 20.12.1966 “Për një ndryshim në ligjin nr. 7786, datë 27.1.1994 “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar.

⁷ VKM nr. 13, datë 5.1.1998 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “k”, çmimi i shitjes së apartamenteve në Elbasan është 12,050 lekë/m² (12,050 lekë/m² x 81m² = 976,050 lekë).

⁸ Në përgjigjen nr. 2 të pyetësonit nr. 3.

⁹ Përgjigjja nr. 2 e pyetësonit nr. 3.

¹⁰ Përgjigjja nr. 2 e pyetësonit nr. 3, shkresa nr. *** prot., datë 31.5.2024, e AMGKP-së.

kredisë për subjektin në shumën 500,000 lekë, me qëllim “Blerje shtëpi banimi”, kredi e shlyer në vitin 2005¹¹.

22.9 Në lidhje me burimin “Kursimet nga pagat të subjektit dhe bashkëshortit”, Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të kursyer shumën 500,000 lekë për periudhën 1995 – 5.3.1996. Nga analiza¹² rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kishin mundësi financiare për të kursyer shumën 500,000 lekë për shkak të balancës negative -155,678 lekë.

22.10 Komisioni konstatoi se subjekti ka bërë deklaram jo të plotë të burimit të krijimit të pasurisë apartament me sip. 81 m² në deklaratën *Vetting*, pasi nuk ka deklaruar si burim “kursimet nga pagat”, si dhe ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 155,678 lekë për krijimin e kursimeve *cash* prej 500,000 lekësh, të përdorur për blerjen e apartamentit me sip. 81 m².

22.11 Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

22.12 Subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës ka shpjeguar se *mosdeklarimi në Vetting i burimit “kursimet nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit”, në shumën 500,000 lekë, është një harresë dhe jo deklaram i paplotë, sepse thjesht nuk janë detajuar këto burime*. Kjo pasuri dhe burimi i krijimit të saj janë deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, që është kryer në mars të vitit 2004. Në lidhje me konstatimin se subjekti duket se ka mungesë burimesh të ligjshme në shumën 155,678 lekë për krijimin e kursimeve *cash* prej 500,000 lekësh, të përdorur për blerjen e apartamentit me sip. 81 m², subjekti shpjegoi në prapësime se kryerja e analizës financiare nga Komisioni vetëm për periudhën 1995 – 5.3.1996 është i padrejtë dhe joproportional, pasi subjekti ka punuar dhe realizuar të ardhura si prokurore që nga viti 1987 dhe jo që nga viti 1995. Ajo pretendoi gjithashtu se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë në analizë as të ardhurat ndër vite të krijuara nga bashkëshorti i saj. Subjekti pretendoi se sipas analizës financiare për periudhën 1987 – 2016, të depozituar prej saj, familja e saj ka pasur mundësi financiare për të kursyer shumën 500,000 lekë për plotësimin e çmimit të blerjes së apartamentit dhe nuk ekziston balanca negative -155,678 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

22.13 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se rezultoni e provuar se subjekti nuk i ka deklaruar “kursimet nga pagat” si burim krijimi të pasurisë apartament me sip. 81 m² në DIPP-në e vitit 2003, ashtu sikurse pretendon në prapësime, por vetëm në pyetësorin standard. Gjithsesi, kjo është një pasaktësi, relevanca e së cilës nuk është domethënëse. Deklarimi në deklaratën *Vetting* të burimit të saktë mbetet një element i rëndësishëm në raport me kontrollin e burimit të kësaj pasurie.

22.14 Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit për të kursyer shumën 500,000 lekë për plotësimin e çmimit të blerjes së apartamentit, me balancë negative -155,678 lekë, Komisioni

¹¹ Vërtetim nr. *** prot., datë 21.9.2005 i ATK-së, bashkëlidhur shkresa nr. *** prot., datë 31.5.2024.

¹² Pasuritë 500,000 lekë (kursime *cash*) + detyrime 0 = 500,000 lekë minus të ardhurat nga paga e subjektit 491,888 lekë (paga e bashkëshortit dhe dietat = 0 lekë) minus shpenzime jetike 147,566 lekë = mundësia për kursime -155,678 lekë.

vlerëson se pavarësisht se subjekti nuk ka dokumentuar të ardhurat për periudhën 1987 – 31 dhjetor 1994, në analizën financiare të kryer, për të vlerësuar mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* në shumën 500,000 lekë, Komisioni në mungesë të një informacioni dhe për një qëndrim garantist kundrejt subjektit, bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 2.9.2019, të ZABGJ-së, referuar nivelit të pagave për gjyqtarët, ka përllogaritur të ardhurat për vitet 1991 – 1994 dhe i ka përfshirë ato në analizën e dërguar me rezultatet e hetimit, ku periudha është shënuar 1995 – 5.3.1996 dhe jo 1991 – 5.3.1996. Për sa i përket të ardhurave para viteve 1990, ashtu sikundër është konstatuar edhe nga Kolegji, vlerat e pagave kanë qenë në nivele të papërfillshme dhe nuk kanë peshë në konsiderim të mundësisë për të krijuar kursime. Edhe nëse Komisioni do të merrte në konsideratë pretendimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me pagat në vitet 1987 – 1994, që sipas deduksionit rezultojnë të deklaruara nga subjekti në shumën 279,260 lekë (18,854,877 lekë, deklaruar në deklaratën *Vetting* - 18,575,617 lekë, provuar me dokumentacion nga subjekti), në vend të shumës 216,273 lekë të përllogaritur nga Komisioni për periudhën 1991 – 1994, përsëri analiza financiare do të rezultonte me një balancë negative në shumën 92,691 lekë.

22.15 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë se burimet për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të krijuara në mënyrë të ligjshme, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

23. Apartament banimi me sip. 82 m², ndodhur në lagjen “**”, rruga “****”, Vlorë,** sipas kontratës së porosisë nr. *** rep., nr. *** kol. datë 21.12.2007. Pronësia nuk është fituar ende, pasi nuk është realizuar blerja dhe regjistrimi në ZVRPP-në Vlorë. Vlera: 48,000 euro. Pjesa takuese: 50%. **Burimi i krijimit:** Kredi nga Alpha Bank në shumën 48,000 euro, në datën 30.12.2007. Shlyerja e kredisë ka përfunduar në datën 4.1.2011. Për mbylljen e kredisë u shfrytëzuan depozitat e përbashkëta bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank, Elbasan, në vlerën 23,000 euro, plus 1,500,000 lekë, e barabartë me 10,800 euro, plus *cash* në vlerën 1,500,000 lekë, e barabartë me 10,800 euro, si dhe 1,100 euro të marra nga paratë e mbartura *cash* si kursime në shtëpi. Kursimet në banesë janë krijuar me pagat e subjektit dhe kryesisht të bashkëshortit (deklaruar edhe nga bashkëshorti i subjektit)¹³.

¹³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting* dokumente provuese: (i) kontratë kapari nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.12.2007, ku shtetasi TH.B premtori t'u shesë blerësve të ardhshëm, shtetasve P dhe Rajmonda Berisha, një apartament (1+1) me vlerë 64,000 euro, në katin e tretë, nga një pallat 8-katësh që do të ndërtojë shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k. mbi truallin në pronësi të tij. Palët kanë deklaruar se në datën e nënshkrimit të kontratës është paguar kësti 16,000 euro dhe brenda datës 15.2.2008 do të likuidohet shuma 48,000 euro. Kontrata përfundimtare e shitjes do të realizohet kur të regjistrohet pasuria në ZVRPP Vlorë nga shitësi i ardhshëm; (ii) vendim nr. ***, datë 19.12.2005, i KRRT-së, për sheshin e ndërtimit të pallatit 8-katësh; planimetria e sheshit të ndërtimit; planimetria e sipërfaqeve të apartamenteve; (iii) depozitë prej 45,700 euro në arkë në Alpha Bank, në datën 4.1.2011, nga shtetasit P e Rajmonda Berisha; (iv) pasqyra e amortizimit të kredisë në Alpha Bank, në shumën 48,000 euro, me afat 20-vjeçar; (v) nxjerrje llogarie bankare në Alpha Bank nga data 1.12.2007, në emër të shtetasve Rajmonda e P. B, ku rezulton se në datën 28.12.2007 është çelur kredia me vlerë 48,000 euro dhe është kryer pagesa në shumën 47,644 euro për shoqërinë “****” sh.p.k. për blerje apartamenti; (vi) nxjerrje llogarie bankare nga Alpha Bank për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2010, në emër të shtetasve Rajmonda e P.B; (vii) shlyerja kredie në datën 4.1.2011 në Alpha Bank, nga shtetasi P.B, në shumën 43,474 euro; (viii) nxjerrje llogarie bankare, datë 24.1.2017, nga Intesa Sanpaolo Bank, në emër të shtetasve P e Rajmonda Berisha, ku rezulton se në datën 3.1.2011 janë maturuar depozitat në shumat totale 1,528,200 lekë, 1,302,319 lekë dhe 225,881 lekë dhe është tërhequr shuma 1,502,689 lekë; (ix) vërtetim datë 25.1.2017 nga Intesa Sanpaolo Bank, ku konfirmohet se shtetasit Rajmonda e P.B kanë qenë klientë të Bankës Amerikane me llogari të hapura në datën 12.2.2004. Depozitimet fillestare janë në vlerën 500,000 lekë dhe llogaritë e përbashkëta

23.1 Subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2007: “Kredi bankare e marrë nga Alpha Bank në shumën 48,000 euro, për blerje shtëpie në të njëjtën vlerë. Miratuar në datën 28.12.2007, me afat 20 vjet, me kështë mujor 316,3 euro. Interesi 5%, nr. i llogarisë = ***. Kontrata e blerjes datë 21.12.2007, nr. *** rep., *** kol.; kontrata e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol. Në emër të bashkëshortit. Shlyerja ka filluar në datën 28.1.2008”. Në DIPP-në e viteve 2008, 2009 dhe 2010 janë deklaruar interesat vjetorë të kredisë prej 48,000 euro të paguar nga subjekti. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: “Është likuiduar pjesa e mbetur e kredisë së marrë tek Alpha Bank në shumën e mbetur prej 43,474.32 euro. Pagesa para afatit 2,173.64. Totali 45,674.96 euro.

Për të likuiduar huan e mbetur tek Alpha Bank janë mbyllur depozitat bankare në euro dhe lekë tek Intesa Sanpaolo Bank. Vlerat 23,000 euro dhe 1,500,000 lekë.

Për të likuiduar huan e mbetur tek Alpha Bank janë përdorur edhe një shumë e likuiditeteve gjendje në shtëpi, në lekë dhe euro. Vlera 1,500,000 lekë u konvertua në 10,870 euro + 1,000 euro”.

23.2 Nga hetimi rezultoi se në ZVRPP-në Vlorë dhe ASHK Drejtoria Vendore Vlorë¹⁴ nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

23.3 Sipas FSHU-së¹⁵, në emër të shtetasit P.B është lidhur kontrata nr. *** në datën 20.2.2015, në adresën lagjja “***”, Vlorë.

23.4 Referuar çmimit të EKB-së¹⁶, rezultoi se apartamenti me sip. 82 m² është blerë më shtrenjtë sesa çmimi referencë, për rrjedhojë Komisioni nuk ka ngritur dyshime për favorizim të subjektit në çmimin e blerjes së apartamentit. Pavarësisht nga kjo, Komisioni hetoi për konflikt interesi midis subjektit dhe shtetasit TH.B, por nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë¹⁷.

23.5 E pyetur në ILDKPKI¹⁸ për vlerën e saktë të blerjes së apartamentit (48,000 euro apo 64,000 euro), subjekti ka deklaruar: “...kur merr një kredi në bankë, funksionon që duhet të kërkosh një vlerë më të madhe se ajo që të duhet, për shkak se banka nuk ta jep 100% të vlerës, kështu që morëm 70% të saj, por vlera është 48,000 euro, sa i kam shlyer bankës”.

23.6 Referuar kontratës së kaparit datë 21.12.2007, rezulton se në këtë datë subjekti ka paguar vlerën 16,000 euro dhe, referuar dokumentacionit bankar, rezulton se në datën 28.12.2007, kur është lëvruar kredia me vlerë 48,000 euro, subjekti i ka paguar shumën 47,644 euro shoqërisë

janë në vlerën 3,000 euro. Këto depozita janë mbyllur në datën 3.1.2011. Bashkëlidhur vërtetimit janë disa nxjerrje llogarie në emër të shtetasve Rajmonda e P.B.

¹⁴ Shkresa nr. ***, datë 23.8.2017, e ZVRPP Vlorë; email datë 30.1.2020 i ASHK Drejtoria Vendore Vlorë (dosja Vetting, aneks nr. 27, nr. 29).

¹⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 13.5.2024, e FSHU-së.

¹⁶ Udhëzim nr. 2, datë 4.4.2007 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB dhe të koeficientit k për vitin 2007”, çmimi i apartamenteve në tregun e lirë në Vlorë është 49,335 lekë/m² (49,335 lekë/m² x 82 m² = 4,045,470 lekë). E konvertuar kjo vlerë në euro me kursin e këmbimit 120,40, rezulton se vlera e apartamentit duhej të ishte 33,600 euro.

¹⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 24.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

¹⁸ Email datë 27 – 28.1.2016 në shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021, të ILDKPKI-së (fq. 250).

“***” sh.p.k. Pra, deri në datën 28.12.2007, për çmimin total të apartamentit 64,000 euro është paguar shuma 63,644 euro.

23.7 Sa më sipër, Komisioni konstatoi mospërputhje të vlerës 48,000 euro të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe në ILDKPKI, me vlerën 64,000 euro të dokumentuar në kontratën e kaparit dhe në dokumentin bankar “Vendim për kufi kredie e huadhënie nr. ***, datë 24.11.2007”¹⁹, si dhe subjekti nuk ka deklaruar burimin e shumës 16,000 euro të paguar sipas kontratës së kaparit në datën e lidhjes së saj, 21.12.2007.

23.8 Për këtë mospërputhje çmimi dhe për burimin e shumës 16,000 euro, subjekti ka shpjeguar gjatë hetimit se²⁰ pavarësisht parashikimeve në kontratën e kaparit datë 21.12.2007, me marrëveshje të palëve kontraktore, i gjithë çmimi i apartamentit është paguar në datën e lëvrimit të kredisë në vlerën 48,000 euro. Shuma 16,000 euro nuk është paguar ndonjëherë dhe këtë fakt e provon deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2021, e shitësit TH.B, bashkëlidhur shpjegimeve dhe deklarimi i subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, në vitin 2016. Sipërfaqja totale e apartamentit është 80 m² sipas kontratës së porosisë, çmimi/njësi është 600 euro/m² dhe vlera totale është 48,000 euro. Subjekti nuk disponon kontratë shitblerjeje, pasi shitësi ende nuk e ka kolauduar objektin dhe nuk ka marrë lejen e shfrytëzimit të tij. Bashkëlidhur shpjegimeve është depozituar mandati bankar datë 4.1.2011 nga Alpha Bank për shlyerje kredie në vlerën 43,474 euro.

23.9 Në deklaratën noteriale datë 26.1.2021, shtetasi TH.B deklaroi se mes tij, subjektit e bashkëshortit të saj është lidhur një kontratë kapari²¹ datë 21.12.2007 për shitjen e apartamentit, ku pavarësisht se kanë shënuar që shuma 16,000 euro është likuiduar me nënshkrimin e kontratës, ai e ka nënshkruar këtë me mirëbesim, pasi klientët i njihte personalisht dhe i kishin premtuar që këtë shumë do t’ia likuidonin më pas, por deri në datën e deklaratës këtë shumë nuk e ka marrë as *cash*, as me bankë.

23.10 Komisioni vlerësoi se kjo deklaratë noteriale nuk i provoi shpjegimet e subjektit se vlera e apartamentit është 48,000 euro dhe se shuma 16,000 euro nuk është paguar asnjëherë prej saj, kjo sepse deklaruesi TH.B nuk ka deklaruar as që subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk do ta paguanin shumën 16,000 euro si pjesë përbërëse të çmimit prej 64,000 euro dhe as që vetë deklaruesi ka hequr dorë nga marrja e kësaj shume.

23.11 Gjithashtu, ekzistenca e një kontrate kapari dhe jo e një kontrate tjetër (p.sh. kontratë sipërmarrjeje), tregon se: *së pari*, palët duke zgjedhur këtë tip kontrate kanë rënë dakord për pagesën e shumës 16,000 euro në momentin e lidhjes së kontratës si kapar që do të garantonte shitjen e apartamentit; *së dyti*, palët kanë kërkuar siguri juridike nga njëra-tjetra për shitjen e apartamentit, veprim ky që zbeh besueshmërinë e deklaramit të shtetasit TH.B se palët ishin në mirëbesim dhe kishin njohje personale.

23.12 Gjithashtu, referuar neneve 601 dhe 602 të Kodit Civil, referuar faktit që apartamenti posedohet nga subjekti, e provuar kjo me deklaramet e subjektit në ILDKPKI dhe kontratën e

¹⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2021, të Alpha Bank.

²⁰ Përgjigjja nr. 1 e pyetësorit nr. 2.

²¹ Kontratë kapari nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.12.2007.

energjisë elektrike, si dhe faktit të kryerjes së pagesës prej 48,000 euro, provohet shitja e apartamentit, pavarësisht se deri në këtë moment shitja nuk është formalizuar me akt të shkruar dhe, si rrjedhojë, kontrata e kaparit nuk është bërë e pavlefshme.

23.13 Për këto arsye, Komisioni e ka përfshirë pagesën e vlerës 16,000 euro si shpenzim në analizën financiare.

Analiza financiare për mundësinë e krijimit të apartamentit me sip. 81 m²

23.14 Komisioni hetoi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie të deklaruar në *Vetting*, “kredi nga Alpha Bank në shumën 48,000 euro”, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit është kredimarrëse në Alpha Bank²². Sipas vendimit për kufi kredie e huadhënieje nr. ***, datë 24.11.2007, është miratuar një kufi kredie në shumën 48,600 euro për bashkëkredimarrësit P e Rajmonda Berisha me qëllim financimin e blerjes së apartamentit me sip. 78 m², i ndodhur në Vlorë, lagjja “***”, pasuria nr. ***, z. k. ***. Kostoja e përgjithshme e projektit të financimit është në shumën 64,000 euro, ku kontributi i kredimarrësve është 30% ose 19,000 euro dhe kontributi i bankës është 70% ose 45,000 euro. Afati është 20 vjet dhe norma bazë e interesit është fikse, 5% për 5 vitet e para. Me këtë vendim, banka gjithashtu ka miratuar Visa Card 3,000 euro dhe *overdraft* me limit 600 euro.

23.15 Referuar nxjerrjes së llogarisë për periudhën 1.12.2007 – 6.2.2009 dhe planit të amortizimit të kredisë 48,000 euro të depozituar nga subjekti në deklaratën *Vetting*²³, ka rezultuar se në datën 28.12.2007 është disbursuar kredia në shumën 48,000 euro dhe, pasi janë paguar shpenzimet noteriale për lidhjen e kontratës, vlerësimin e pronës dhe komisionin e disbursimit, është transferuar për llogari të shoqërisë “****” shuma 47,644 euro me përshkrimin “Sa kaluar nga P. B për blerje apartamenti”.

23.16 Për shlyerjen e kredisë ka rezultuar se për periudhën 2.3.2009 – 14.12.2020 subjekti ka paguar çdo muaj 320 euro këstin e kredisë, si dhe është depozituar *cash* shuma 45,700 euro në datën 4.1.2011 për mbylljen përfundimtare të kredisë. Si burim për shlyerjen e kredisë subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2011: (i) depozitat e përbashkëta bankare në Intesa Sanpaolo Bank në vlerën 23,000 euro; (ii) plus 1,500,000 lekë, e barabartë me 10,800 euro; (iii) plus *cash* 1,500,000 lekë, e barabartë me 10,800 euro; (iv) 1,100 euro nga paratë e mbartura *cash* si kursime në banesë.

23.17 Me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së këtyre burimeve të deklaruara për shlyerjen e kredisë, Komisioni analizoi secilin nga burimet.

Analiza financiare e krijimit të depozitave në shumën 22,979.6 euro të tërhequra në datën

3.1.2011 për shlyerjen e parakohshme të kredisë

23.18 Nga hetimi ka rezultuar se shtetasi P.B ka tërhequr *cash* vlerën 22,979.6 euro nga Intesa Sanpaolo Bank në datën 3.1.2011. Kjo shumë ka si burim depozitat e krijuara dhe të maturuara

²² Shkresa nr. *** prot., datë 25.3.2021, e Alpha Bank.

²³ Alpha Bank, me përgjigjen e datës 25.3.2021, sipas shkresës nr. *** prot., për shkak të pamundësisë për të aksesuar platformat e mëparshme, ka vënë në dispozicion informacion që i korrespondon periudhës 2.3.2009 e në vijim.

ndër vite²⁴ prej 17,553.77 euro²⁵ dhe 5,425.83 euro²⁶. Depozita 17,553.77 euro është gjeneruar nga depozita fillestare prej 3,000 euro e krijuar në datën 12.2.2004, e shtuar me depozitimet *cash* 7,000 euro në datën 29.6.2004 dhe 5,000 euro në datën 3.2.2006, si dhe nga interesat bankarë. Ndërsa depozita 5,425.83 euro ka si burim depozitim *cash* të shumës 5,000 euro në datën 10.12.2007.

23.19 Pas analizës financiare të fragmentuar²⁷, për verifikimin e mundësisë së subjektit dhe bashkëshortit të saj për të çelur depozitën 3,000 euro në datën 12.2.2004, ku si burim të ardhurash janë përfshirë të ardhurat e dokumentuara gjatë periudhës 1.1.2004 – 12.2.2004, si dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojë depozitën 3,000 euro në datën 12.2.2004, për shkak të balancës negative të analizës financiare prej - 298,772 lekësh.

23.20 Pas analizës financiare të fragmentuar për periudhën 12.2.2004 – 29.6.2004²⁸, për verifikimin e mundësisë për krijimin e shtesës së depozitës me vlerë 7,000 euro, në datën 29.6.2004, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme që të krijojë këtë shtesë, për shkak të balancës negative prej 726,367 lekësh.

23.21 Pas analizës financiare për verifikimin e mundësisë për krijimin e shtesës së depozitës prej 5,000 euro në datën 3.2.2006, të deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2006 (për të cilën nuk ka deklaruar burim krijimi), ka rezultuar se subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 “*Likuiditet, kursime të vitit 2005. Shuma 700,000 lekë*”, ndërsa në DIPP-në e vitit 2006 ka deklaruar “*Cash në shtëpi, kursime të vitit 2006. Shuma 920,000 lekë*”. Pra, subjekti nuk ka deklaruar si burim krijimi për depozitim 5,000 euro të datës 3.2.2006 gjendjen *cash* të deklaruar në fund të vitit 2005. Por, edhe nëse Komisioni do ta konsideronte këtë gjendje *cash* si burim të mundshëm, nga analiza financiare e vitit 2005 subjekti ka rezultuar me një balancë negative 793,344 lekë, e cila cenon ligjshmërinë e gjendjes *cash* të krijuar në vitin 2005, në shumën 700,000 lekë. Gjithashtu, pagat e përfituara në periudhën 1.1.2006 – 3.2.2006 janë në një vlerë shumë më të vogël sesa depozitimi *cash* 5,000 euro. Në përfundim, duket se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë qenë në pamundësi financiare për krijimin e shtesës së depozitës 5,000 euro në datën 3.2.2006.

23.22 Për sa i takon depozitës së maturuar 5,425.83 euro, e cila ka si burim depozitim *cash* të shumës 5,000 euro në datën 10.12.2007, subjekti e ka deklaruar këtë depozitë në DIPP-në e vitit 2007 me burim “nga dietat e shërbimit të bashkëshortit”. Sipas praktikës së Komisionit, vlerat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit në formën e dietave kanë destinacion mbulimin e shpenzimeve për ushqim dhe fjetje të kryera gjatë udhëtimeve të punës, prandaj në analizën

²⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 16.3.2021, e Intesa Sanpaolo Bank; kthim përgjigjeje datë 25.1.2017 nga Intesa Sanpaolo Bank, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁵ Depozitë nr. ***, me datë fillimi 3.2.2006 dhe datë mbarimi 3.1.2011.

²⁶ Depozitë nr. ***, me datë fillimi 10.12.2007 dhe datë mbarimi 3.1.2011.

²⁷ Pasuritë 380,220 lekë: pasuri neto (pasuri – detyrime) 380,220 lekë; të ardhurat 164,091 lekë (të ardhurat nga paga e subjektit 144,803 lekë + të ardhurat nga paga e bashkëshortit 19,288 lekë); Shpenzimet 82,643 lekë (shpenzime jetike 62,643 lekë + shpenzime mobilimi 20,000 lekë) = mundësia për kursime -298,772 lekë.

²⁸ Analiza është kryer e fragmentuar 12.2.2004 – 29.6.2004, për shkak se në periudhën 1.1.2004 – 12.2004 subjekti rezultoi me balancë negative. Pasuritë (shtesa/pakësime të likuiditeteve) 889,260 lekë: të ardhurat 328,179 lekë (të ardhurat nga paga subjekti 289,606 lekë + të ardhurat nga paga e bashkëshortit 38,573 lekë); shpenzimet 162,285 lekë (shpenzime jetike 125,285 lekë + shpenzime mobilimi 40,000 lekë) = mundësia për kursime -726,367 lekë.

financiare këto dieta nuk janë konsideruar në zërin e të ardhurave, por janë reduktuar shpenzimet e jetesës së bashkëshortit të subjektit. Gjithashtu, nga analiza financiare e vitit 2007 duket se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojnë depozitën 5,000 euro në datën 10.12.2007, pasi për vitin 2007 rezultojnë me një balancë negative -3,509,814 lekë.

23.23 Në mënyrë të përmbledhur, Komisioni ka konstatuar se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojnë ndër vite depozitat në shumën totale 22,979.6 euro, që janë tërhequr në datën 3.1.2011 me destinacion shlyerjen e kredisë, pasi kanë rezultuar me balanca negative në datat e depozitimeve *cash* (12.2.2004 depozituar 3,000 euro; 29.6.2004 depozituar 7,000 euro; 3.2.2006 depozituar 5,000 euro dhe 10.12.2007 depozituar 5,000 euro).

Analiza financiare e krijimit të depozitave në shumën 1,502,689 lekë, të tërhequra në datën 3.1.2011 për shlyerjen e parakohshme të kredisë

23.24 Ka rezultuar se shtetasi P.B ka tërhequr *cash* shumën 1,502,689 lekë në datën 3.1.2011 nga llogaria e tij dhe e subjektit pranë Intesa Sanpaolo Bank²⁹. Kjo shumë ka si burim depozitat e krijuara ndër vite, konkretisht depozitat e maturuara në shumat 1,302,319 lekë³⁰ dhe 225,881 lekë³¹. Depozita 1,302,319 lekë është gjeneruar nga depozita 500,000 lekë e krijuar në datën 12.7.2004 dhe depozitimi *cash* i shumës 500,000 lekë në datën 3.2.2006 nga bashkëshorti i subjektit, ndërsa depozita 225,881 lekë ka si burim depozitimin *cash* të shumës 200,000 lekë në datën 10.12.2007.

23.25 Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 depozitën bankare 500,000 lekë të krijuar në datën 12.7.2004. Në analizën financiare të fragmentuar për verifikimin e mundësisë së subjektit dhe bashkëshortit të saj për të investuar çeljen e depozitës 500,000 lekë në datën 12.7.2004, janë përfshirë si burim krijimi të ardhurat e dokumentuara në periudhën 29.6.2004 – 12.7.2004 dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së. Ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme që të krijojë depozitën 500,000 lekë në datën 12.7.2004, për shkak të balancës negative -459,276 lekë³².

23.26 Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2006 shtesën e depozitës 500,000 lekë të datës 3.2.2006, por nuk ka deklaruar burim krijimi për të. Nga leximi i deklaratave periodike rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 “*Likuiditet, kursime të vitit 2005. Shuma 700,000 lekë*”, ndërsa në DIPP-në e vitit 2006 ka deklaruar “*Cash në shtëpi, kursime të vitit 2006. Shuma 920,000 lekë*”.

23.27 Pra, subjekti nuk ka deklaruar si burim krijimi për depozitimin 500,000 lekë të datës 3.2.2006 gjendjen *cash* të deklaruar në fund të vitit 2005. Por, edhe nëse Komisioni do ta konsideronte këtë gjendje *cash* si burim të mundshëm, nga analiza financiare e vitit 2005 subjekti

²⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 16.3.2021, e Intesa Sanpaolo Bank.

³⁰ Depozitë nr. ***, me datë fillimi 3.2.2006 dhe datë mbarimi 3.1.2011.

³¹ Depozitë nr. ***, me datë fillimi 10.12.2007 dhe datë mbarimi 3.1.2011.

³² Pasuritë 500.000 lekë (shtesa/pakësime të likuiditeteve); Të ardhurat 82,045 lekë (të ardhurat nga paga e subjektit 72,401 lekë + të ardhurat nga paga e bashkëshortit 9,644 lekë); Shpenzimet 41,321 lekë (shpenzime jetike 31,321 lekë + shpenzime mobilimi 10,000 lekë) = mundësia për kursime 459,276 lekë.

ka rezultuar me një balancë negative -793,344 lekë, e cila cenon ligjshmërinë e gjendjes *cash* 700,000 lekë të krijuar në vitin 2005. Gjithashtu, pagat e përfituara në periudhën 1.1.2006 – 3.2.2006 janë në një vlerë shumë më të vogël sesa depozitimi *cash* 500,000 lekë. Në përfundim, duket se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë qenë në pamundësi financiare për krijimin e shtesës së depozitës 500,000 lekë, në datën 3.2.2006.

23.28 Për sa i takon depozitës së maturuar në vlerën 225,881 lekë, krijuar me depozitim *cash* të shumës 200,000 lekë në datën 10.12.2007, u konstatua se subjekti e ka deklaruar këtë depozitë në DIPP-në e vitit 2007 me burim “nga kursimet në lekë me bashkëshortin”. Nga analiza financiare e vitit 2007 duket se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të krijuar depozitën 200,000 lekë në datën 10.12.2007, pasi për vitin 2007 rezultojnë me një balancë negative -3,509,814 lekë.

23.29 Në mënyrë të përmbledhur, Komisioni konstaton se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi për të krijuar ndër vite me të ardhura të ligjshme depozitat në vlerën 1,502,689 lekë, të përdorura në datën 3.1.2011 për shlyerjen e kredisë, pasi kanë rezultuar me balanca negative në datat e depozitimeve *cash* (12.7.2004 depozituar 500,000 lekë; 3.2.2006 depozituar 500,000 lekë; 10.12.2007, depozituar 200,000 lekë).

Analiza financiare e ligjshmërisë së gjendjes *cash* në vlerën 1,500,000 lekë (e barabartë me 10,800 euro) dhe 1,100 euro, krijuar nga paratë e mbartura *cash* si kursime në shtëpi

23.30 Ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen *cash* të datës 31 dhjetor në DIPP-në e viteve 2005 – 2016, me përjashtim të DIPP-së së vitit 2006, ku deklaroi “*Cash në shtëpi kursime të vitit 2006. Vlera 920,000 lekë*” dhe Komisioni këtë vlerë e konsideroi si “shtesë” dhe jo “gjendje” për këtë vit.

23.31 Në këto deklarime të subjektit është konstatuar se gjendja *cash* e deklaruar në datën 31.12.2010 është 2,000,000 lekë dhe 10,800 euro, shumë kjo e mjaftueshme për të mbuluar vlerën e përdorur për shlyerjen e kredisë prej 1,500,000 lekësh dhe 1,100 euro.

23.32 Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë mungesë burimesh të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive, ndër të cilat edhe për gjendjen *cash* të deklaruar, sepse për periudhën 2005 (deklarimi i parë *cash*) deri në vitin 2010 (gjendja *cash* e deklaruar në momentin para shlyerjes së kredisë) kanë rezultuar me balanca negative. Në këto kushte, gjendja *cash* e deklaruar si burim për mbylljen e kredisë nuk mund të shërbejë si një burim i ligjshëm.

23.33 Sa më sipër, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, meqë duket se subjekti i rivlerësimit:

- Ka bërë deklaram të rremë të çmimit të apartamentit, pasi në deklaratën *Vetting* ka deklaruar çmimin 48,000 euro, ndërkohë që në kontratën e kaparit, datë 21.12.2007, palët kanë përcaktuar çmimin 64,000 euro.
- Ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit në vlerën 64,000 euro, pasi nuk u provua burimi i ligjshëm i shumës 16,000 euro të paguar si kapar në datën 21.12.2007.

- Ka mungesë burimesh të ligjshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2011, pasi nuk u provua ligjshmëria e burimeve të deklaruara se janë përdorur për shlyerjen e saj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

23.34 Në prapësime, subjekti ka dhënë këto shpjegime për barrën e provës:

23.34.1 *Në lidhje me dy konstatimet e para të Komisionit*, subjekti shpjegon se çmimi i apartamentit është 48,000 euro dhe jo 64,000 euro, sikurse rezulton në kontratën e kaparit datë 21.12.2007, prandaj nuk ka bërë deklaram të rremë të çmimit në deklaratën *Vetting* duke argumentuar se:

- a. Që në DIPP-në e vitit 2007 ka deklaruar: *“Kredi bankare e marrë nga Alpha Bank në shumën 48,000 euro për blerje shtëpie në të njëjtën vlerë...”*.
- b. Nuk ekziston një kontratë shitblerjeje³³ që provon çmimin 64,000 euro, pasi objekti nuk është kolauduar dhe nuk është marrë ende leja e shfrytëzimit të tij. Kontrata e kaparit nuk është kontratë shitblerjeje.
- c. Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2021, e shtetasit TH.B, provon përtej çdo interpretimi se deri në datën e kësaj deklarate ai nuk ka marrë shumën 16,000 euro. Shënimi i kësaj shume në kontratën e kaparit nuk provon pagesën.
- d. Ka një *email* në ILDKPKI, në vitin 2016, ku subjekti i ka deklaruar këtij institucioni vlerën e apartamentit 48,000 euro. Ky sqarim në *email*, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016³⁴ dhe nën dritën e vendimit nr. 37/2021 të Kolegjit³⁵ ka vlerën e provës për të sqaruar vlerën reale të blerjes.

23.35 Të gjitha këto akte shkresore përbëjnë prova edhe në referim të neneve 11, 246, 253, 260 dhe 261 të Kodit të Procedurës Civile, neneve 80 dhe 81 të Kodit të Procedurave Administrative, ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, si dhe të ligjit nr. 84/2016, neni 45, pika 2, neni 49, pika 1, shkronja “b” dhe pika 4, nenet 50, 53 e 55 e vijues. Gjithashtu, në lidhje me fuqinë provuese të akteve shkresore, subjekti ka sjellë në vëmendje edhe vendimin nr. 1, datë 31.1.2019, të Kolegjit³⁶.

³³ Udhëzimet nr. 9, datë 26.2.2008, nr. 29, datë 30.7.2018 dhe nr. 34, datë 29.12.2023, përcaktojnë se: *“Vlera në shitje e pasurisë së paluajtshme përcaktohet në kontratën e noterizuar të shitjes, e cila është firmosur nga palët. Kontrata duhet të shprehë sipërfaqen në metër katror të pasurisë, çmimin për metër katror dhe vlerën e saj. Kontrata duhet të jetë e shoqëruar me hartën, planimetrinë dhe dokumentet e tjera, që shërbejnë për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme”*.

³⁴ Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016: *“Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit”*.

³⁵ Vendimi nr. 37/2021 i Kolegjit, pika 10.21: *“Subjekti ka dhënë në përgjigje të pyetjeve të pasqyruara në procesverbalin datë 17.11.2011 dhe të shtruara nga inspektorja e lartë e ILDKPKI-së... Ky procesverbal i hartuar, mbështetur mbi një dispozitë ligjore nga organi kompetent, vlerësohet se është një dokument zyrtar në kuptim të nenit 49, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, i cili për më tepër është administruar nga Komisioni zyrtarisht prej institucionit që e ka hartuar atë në funksion të procesit të rivlerësimit. Kolegji vlerëson me rëndësi të nënvizojë faktin se përpilimi i këtij dokumenti zyrtar jo vetëm që është bërë nga organi kompetent në përputhje me procedurën dhe formën e kërkuar prej ligjit, por ai daton në një kohë të largët e pa lidhje me kontekstin e procesit të rivlerësimit e në zbatim të tagrave ligjorë të tij, duke krijuar bindjen se të dhënat e përfuara në këtë dokument, nëpërmjet shpjegimeve të dhëna nga subjekti, kanë shëruar pasaktësitë në deklarime të subjektit të rivlerësimit në funksion të zbatimit të ligjit nr. 9049/2003, në mënyrë autonome nga procesi i rivlerësimit”*.

³⁶ “36. Në analizë të provave të administruara dhe duke u mbështetur në parashikimin e nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me*

23.36 Për arsye se ka prova, deklaroi subjekti, që provojnë se shuma 16,000 euro nuk është paguar kurrë, subjekti ka kërkuar që shuma 16,000 euro të mos përfshihet në analizë financiare dhe gjithashtu pretendoi se nuk ka detyrimin dhe mundësinë që të provojë burimin e ligjshëm të kësaj shume. Subjekti mbajti të njëjtin qëndrim edhe në seancën dëgjimore, duke deklaruar se nuk e ka paguar shumën 16,000 euro dhe analiza financiare nuk ka diferenca negative.

23.37 Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2011, subjekti shpjegoi se burimet e ligjshme të të ardhurave kanë qenë të mjaftueshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2011, pasi provohet ligjshmëria e burimeve të deklaruar. Në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2011 është deklaruar burimi i të ardhurave për shlyerjen e kredisë me vlerë 48,000 euro, që janë depozitat e përbashkëta bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank në vlerën 23,000 euro, plus 1,500,000 lekë e barabartë me 10,800 euro, plus *cash* 1,500,000 lekë e barabartë me 10,800 euro, si dhe 1,100 euro të marra nga paratë e mbartura *cash* si kursime në shtëpi.

23.38 Depozita në shumën 22,979.6 euro (23,000 euro) është krijuar nga shumata e depozituara dhe të maturuara ndër vite në vlerat 17,553.77 euro dhe 5,425.83 euro dhe të tërhequra në datën 3.1.2011 për shlyerjen e parakohshme të kredisë. Depozita prej 17,553.77 euro është krijuar në periudhën 12.2.2004 – 3.2.2006 nga depozitimet *cash* të shumës fillestare prej 3,000 euro në datën 12.2.2004, plus shumën 7,000 euro në datën 29.6.2004 dhe shumën 5,000 euro në datën 3.2.2006, si dhe nga interesat bankarë.

23.39 Komisioni ka bërë analizë financiare të fragmentuar për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortit të saj për të investuar në çeljen e këtyre depozitave.

23.40 Në lidhje me depozitën fillestare prej 3,000 euro, të krijuar në datën 12.2.2004, Komisioni ka bërë analizë financiare të fragmentuar për periudhat 1.1.2004 – 12.2.2004 dhe 12.2.2004 – 29.6.2004, duke mos përfshirë në këtë analizë të ardhurat e siguruar në shumata 25,000 USD dhe 54,000 DM nga bashkëshorti si shofer pranë shoqërisë private “****” në vitet 1993 – 1995 dhe shoqërinë “****” për periudhën 1.3.1996 – 17.2.2003. Duke u përfshirë këto shuma në analizë financiare, nuk do të rezultojnë diferenca negative.

23.41 Për shtesën e depozitës 5,000 euro në datën 3.2.2006, ajo është deklaruar në DIPP-në e vitit 2006, kursim ky i vitit 2005. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar: *“Likuiditet, kursime të vitit 2005. Shuma 700,000 lekë”*. Pra, kursimet e vitit 2005 mjaftonin që në datën 3.2.2006 subjekti të shtonte shumën 5,000 euro në depozitë. Arsyetimi i Komisionit se *“Edhe nëse konsiderohet kjo gjendje cash si burim i mundshëm, nga analiza financiare e vitit 2005 subjekti ka rezultuar me një balancë negative prej 793,344 lekësh”*, është në kundërshtim me parimin e objektivitetit.

pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”, i lidhur me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e aktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaramëve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti deri në vitin 2011 ka shlyer tërësisht detyrimin kontraktor prej 129,000 eurosh për blerjen e apartamentit 158,1 m²”.

23.42 Në lidhje me krijimin e depozitave në shumën 1,502,689 lekë, tërhequr në datën 3.1.2011 për shlyerjen e parakohshme të kredisë, kjo shumë e ka burimin tek depozitat e krijuara dhe të maturuara ndër vite, në shumat 1,302,319 lekë dhe 225,881 lekë.

23.43 Depozita me vlerë 1,302,319 lekë është gjeneruar nga depozita 500,000 lekë, e krijuar në datën 12.7.2004 dhe nga depozitimi *cash* i vlerës 500,000 lekë në datën 3.2.2006 prej bashkëshortit, ndërsa depozita me vlerë 225,881 lekë ka si burim depozitimin *cash* të shumës 200,000 lekë në datën 10.12.2007.

23.44 Depozita bankare prej 500,000 lekësh e krijuar në datën 12.7.2004 është deklaruar në DIPP-në e vitit 2004. Komisioni ka bërë analizë financiare të fragmentuar për verifikimin e mundësisë financiare të subjektit dhe bashkëshortit të saj për të investuar çeljen e depozitës 500,000 lekë në datën 12.7.2004. Si burim të ardhurash janë përfshirë vetëm të ardhurat e dokumentuara në periudhën 29.6.2004 – 12.7.2004.

23.45 Në analizë financiare nuk përfshihen të ardhurat e siguruara nga bashkëshorti si shofer pranë shoqërisë private “****” në vitet 1993 – 1995; shoqërisë “****” për periudhën 1.3.1996 – 17.2.2003, shoqërisë “****” për periudhën 2003 – 2007, në shumat 25,000 USD, 54,000 DM dhe 16,820 euro. Nëse këto vlera do të përfshiheshin në analizë, atëherë nuk do të rezultonin diferenca negative.

23.46 Për sa i takon depozitës së maturuar në vlerën 225,881 lekë, e krijuar me depozitimin *cash* të shumës 200,000 lekë në datën 10.12.2007, subjekti e ka deklaruar këtë depozitë në DIPP-në e vitit 2007 me burim “kursimet në lekë me bashkëshortin”. Komisioni ka dalë në përfundimin se subjekti nuk ka pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të krijojë depozitën 200,000 lekë në datën 10.12.2007, pasi ka bërë analizë të fragmentuar dhe padrejtësisht referon tek analiza financiare për tërë vitin financiar 2007, në të cilën nuk përfshin të ardhurat nga puna të bashkëshortit.

Vlerësimi i Komisionit

23.47 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se rezulton e provuar se në lidhje me çmimin e apartamentit dhe pagimin e shumës 16,000 euro, gjatë hetimit administrativ krijoi bindjen se vlera e paguar për apartamentin është 64,000 euro, ndërsa subjekti në prapësimet e saj nuk solli ndonjë provë të re për të provuar të kundërtën.

23.48 Rezulton e provuar se palët e kanë formalizuar vullnetin e tyre paraprak për shitblerjen e apartamentit në kontratën e kaparit që është bërë para noterit dhe ka fuqi të plotë ligjore për gjithçka palët kanë deklaruar në atë kontratë. Mungesa e një kontrate shitblerjeje nuk e bën të pavlefshme kontratën e kaparit dhe as nuk zbeh besueshmërinë e kësaj të fundit.

23.49 Nga ana tjetër, as deklarata noteriale datë 26.1.2021 e shtetasit TH.B nuk mund të shfuqizojë kontratën e kaparit në pjesën ku palët deklarojnë se është paguar shuma 16,000 euro në datën e kësaj kontrate. Një kontratë mund të revokohet apo ndryshohet plotësisht ose pjesërisht me një akt tjetër noterial (deklaratë, shtesë kontrate, aneks kontrate) në rastin kur palët shfuqizojnë apo ndryshojnë elemente të kontratës, por jo kur kundërshtojnë një veprim që e kanë shprehur me vullnet të plotë në kontratë para noterit. Pra, pavarësisht se deklarata datë 26.1.2021 është deklarata noteriale, njëra nga palët nuk mund të mohojë atë që ka deklaruar në kontratën e kaparit, e cila është po ashtu akt noterial. Gjithashtu, edhe sikur të konsiderohej deklarimi i shtetasit TH.B në

këtë deklaratë noteriale se nuk e ka marrë shumën 16,000 euro nga subjekti, ky shtetas nga ana tjetër nuk ka deklaruar as që ka hequr dorë nga marrja e kësaj shume dhe as që subjekti e bashkëshorti i saj nuk do ta paguanin shumën 16,000 euro si pjesë përbërëse të çmimit 64,000 euro.

23.50 Në kontratën e kaparit, palët kontraktore janë dakordësuar për disa detaje, si: *“Shtetasi TH.B është cilësuar si pala marrëse e kaparit dhe shitësi i ardhshëm; çmimet në këtë kontratë janë fikse dhe të pandryshuara; nëse pala blerëse e ardhshme nuk shlyen këstin e dytë brenda datës 15.5.2008, atëherë palës shitëse të ardhshme i lind e drejta që të kontraktojë shitjen e apartamentit tek persona të tretë dhe pala blerëse e ardhshme e humbet plotësisht shumën e paguar si këst i parë”*.

23.51 Komisioni sjell në vëmendje edhe vendimin për kufi kredie e huadhënieje nr. ***, datë 24.11.2007³⁷, që ka miratuar një kufi kredie në shumën 48,600 euro dhe ku citohet se: *“Kostoja e përgjithshme e projektit të financimit është në shumën 64,000 euro, ku kontributi i kredimarrësve është 30% ose 19,000 euro dhe kontributi i bankës është 70% ose 45,000 euro”*.

23.52 Këto detaje e rrethana nga njëra anë përforcojnë bindjen se palët janë para një kontrate kapari të mirëfilltë, në zbatim të së cilës palët kanë paguar këstin e parë 16,000 euro si kapar dhe këstin e dytë 48,000 euro, madje kryerja e pagesës së këstit të dytë në datën 28.12.2007, pra përpara datës së caktuar 15.5.2008, ka shmangur mundësinë që pala blerëse e ardhshme (subjekti) të humbasë kaparin e paguar në shumën 16,000 euro; nga ana tjetër, e bëjnë të pabesueshme si provë deklaratën noteriale të shtetasit TH.B.

23.53 Për këto arsye, shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe Komisioni vlerëson se çmimi i kësaj pasurie do të konsiderohet në vlerën 64,000 euro.

23.54 Ndonëse subjekti i rivlerësimit deklaroi në prapësime se nuk e ka paguar shumën 16,000 euro, prandaj nuk ka as detyrimin, as mundësinë që të provojë burimin e ligjshëm të kësaj shume, Komisioni për sa kohë krijoi bindjen se kjo shumë është paguar, vlerësoi që për pagimin e kësaj shume ka mungesë burimesh të ligjshme.

23.55 Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për shlyerjen e parakohshme të kredisë në vitin 2011, për të cilën janë përdorur likuiditetet e deklaruara ndër vite, subjekti nuk arriti të provojë burimet e ligjshme për çeljen e depozitave dhe shtesat e tyre, si dhe krijimin e kursimeve *cash* për shkak të balancave negative. Subjekti në prapësimet e tij nuk provoi me dokumentacion ligjor të ardhura të tjera të ligjshme, për të cilat të ishin paguar detyrimet tatimore, përveç atyre që Komisioni përfshiu në rezultatet e hetimit.

23.56 Për pretendimin e subjektit se mungesa e burimeve ka rezultuar për shkak se është kryer analizë e fragmentuar në verifikimin e mundësisë financiare për krijimin e këtyre likuiditeteve dhe nuk janë përfshirë të ardhurat e siguruara nga bashkëshorti në shumat 25,000 USD dhe 54,000 DM për vitet 1995 – 2.2003, Komisioni vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Për sa i përket të ardhurave në shumat 25,000 USD dhe 54,000 DM, ato nuk janë përfshirë në analizën e kryer nga Komisioni, pasi nuk plotësojnë kriterin e parashikuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të

³⁷ Vendim i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

Kushtetutës. Gjithashtu, bazuar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar kursime *cash* dhe, për rrjedhojë, të ardhurat e krijuara para kësaj periudhe janë konsideruar nga ana e Komisionit të konsumuara, prandaj kur është analizuar mundësia e krijimit të depozitës fillestare prej 3,000 euro në datën 12.2.2004, është bërë e fragmentuar vetëm për periudhën 1.1.2004 – 12.2004. Fragmentimi i analizës financiare është kryer edhe për shkak të balancave negative në momente të caktuara të krijimit të pasurive/likuiditeteve, konkretisht Komisioni për të verifikuar mundësinë e shtimit të depozitës me 7,000 euro në datën 29.6.2004, ka kryer analizë të fragmentuar për periudhën 12.2.2004 – 29.6.2004, pasi deri më 12.2.2004 subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e depozitës 3,000 euro. Për të njëjtën arsye, edhe kur është verifikuar mundësia për të krijuar depozitën 500,000 lekë në datën 12.7.2004, analiza është kryer e fragmentuar për periudhën 29.6.2004 – 12.7.2004, pasi deri në datën 29.6.2004 subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurive, likuiditeteve dhe pagesën e shpenzimeve.

23.57 Në depozitimet e kryera në bankë në datën 3.2.2006 në shumat 5,000 euro dhe 500,000 lekë, për të cilat nga subjekti dhe personi i lidhur nuk ishte deklaruar burim krijimi, edhe në një qëndrim garantist të Komisionit ku do t'i konsideroheshin si burim krijimi kursimet *cash* të deklaruara në DIPP-në e vitit 2005, jo vetëm që ato rezultojnë të jenë deklaruar në vlerën 700,000 lekë, vlerë kjo më e vogël se totali i depozitimeve *cash* (5,000 euro dhe 500,000 lekë), por në vitin 2005 sipas analizës financiare subjekti dhe bashkëshorti kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurive, likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve, situatë kjo e cila cenon ligjshmërinë e kursimeve *cash* të deklaruara në deklaratën periodike.

23.58 Komisioni vlerëson se subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh për depozitimet *cash* për krijimin e depozitave kur ka deklaruar si burim dietat e bashkëshortit (si p.sh. depozitimi i datës 10.12.2007 i shumës 5,000 euro), pasi dietat kanë destinacion mbulimin e shpenzimeve të kryera gjatë udhëtimeve të punës dhe, si të tilla, nuk mund të kenë shërbyer për krijimin e kursimeve.

23.59 Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës.

24. Të holla të mbajtura gjendje *cash* në shtëpi. Vlera: 1,300,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga pagat, kursimet dhe përfitimet nga puna e bashkëshortit në formën e dietave dhe bakshisheve (deklaruar edhe nga bashkëshorti).

24.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen *cash* në banesë të datës 31 dhjetor të çdo viti për periudhën 2005 – 2016.

Analiza financiare e mundësisë për kursime *cash*

24.2 Në deklaratën *Vetting* është deklaruar si burim i krijimit të kësaj pasurie: “...të ardhurat nga pagat, kursimet dhe përfitimet nga puna e bashkëshortit në formën e dietave dhe bakshisheve”.

24.3 Në lidhje me të ardhurat nga pagat të bashkëshortit, në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat e provuara me dokumentacion ligjor³⁸, të cilat plotësojnë kriteret e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

24.4 Në lidhje me kursimet dhe përfitimet nga puna e bashkëshortit në formën e dietave dhe bakshisheve, të cilat janë përfituar nga puna pranë shoqërive tregtare “***” Tiranë për periudhën viti 2005 – viti 2007, kur ka përfituar sipas viteve përkatëse: 6,240 euro/vit, 7,800 euro/vit, 7,820 euro/vit; “***” Lushnjë për periudhën 1.2.2008 – 28.2.2013, në vlerën 54,900 euro; “***” sh.p.k. Tiranë për periudhën 4.4.2013 – 31.12.2016, në vlerën 36,600 euro (trajtuar në çështjen 38 të këtij vendimi), nuk janë përfshirë si të ardhura në analizën financiare, pasi: (i) nuk provohet me dokumentacion ligjor shuma e saktë e përfituar nga bashkëshorti i subjektit; (ii) sipas praktikës së Komisionit, vlerat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në formën e dietave kanë destinacion mbulimin e shpenzimeve për nevoja ushqimore apo fjetjeje të kryera gjatë udhëtimeve të punës, prandaj në analizën financiare nuk janë konsideruar në zërin e të ardhurave, por janë reduktuar shpenzimet e jetesës së bashkëshortit të subjektit për kohën e qëndrimit me udhëtime pune.

24.5 Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortit të saj për krijimin e gjendjes *cash* me të ardhura të ligjshme, Komisioni kreu analizën për të gjithë periudhën 2005 – 2016, nga ku rezultoi se ata kanë mungesë burimesh të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive, ndër të cilat edhe gjendja *cash* e deklaruar, pasi për periudhën 2005 – 2016 (2005 – momenti i deklarimit të gjendjes *cash* për herë të parë) kanë rezultuar me balanca negative.

24.6 Sa më sipër, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konkluzionit se duket që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash* dhe shtesa të tjera likuiditetesh, për të krijuar pasuri dhe për të mbuluar shpenzimet gjatë periudhës 2005 – 2016, pasi kanë rezultuar me balancë negative në shumën 15,253,787 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

24.7 Subjekti ka pretenduar në prapësime se, nëse do të përfshihen në analizë financiare të ardhurat nga dietat dhe bakshishet që janë përfituar nga bashkëshortit si i punësuar pranë disa shoqërive tregtare, atëherë provohet se ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj gjendjeje *cash*. Subjekti i ka deklaruar periodikisht dietat dhe bakshishet që janë përfituar në shoqëritë: “***” Tiranë për vitet 2005 – 2007, përkatësisht 6,240 euro/vit, 7,800 euro/vit, 7,820 euro/vit; “***”, Lushnjë, në periudhën 1.2.2008 – 28.2.2013, në vlerën 54,900 euro; “***” sh.p.k., Tiranë, për periudhën 4.4.2013 – 31.12.2016, në vlerën 36,600 euro. Këto deklarime periodike përbëjnë provë për procesin administrativ të rivlerësimit.

24.8 Vetë Komisioni në pikën 2 të rezultateve të hetimit administrativ ka parashtruar se: “*Sikurse konstatohet nga deklaratimet e subjektit, gjendja cash e deklaruar në datën 31.12.2010 është 2,000,000 lekë dhe 10,800 euro, shumë kjo e mjaftueshme për të mbuluar vlerën e përdorur për shlyerjen e kredisë prej 1,500,000 lekësh dhe 1,100 euro*”.

³⁸ Shkresat nr. *** prot., datë 24.2.2024; nr. *** prot., datë 16.4.2024; nr. *** prot., datë 17.4.2024; nr. *** prot., datë 2.3.2021; nr. *** prot., datë 8.3.2024, të ISSH-së.

Vlerësimi i Komisionit

24.9 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se sikurse ka trajtuar hollësisht në pikën 38 të këtij vendimi, ka vlerësuar që dietat dhe bakshishet që janë përfituar nga bashkëshorti i subjektit, i punësuar shofer, të mos i konsiderojë si të ardhura të ligjshme, duke dhënë edhe argumentet për këtë.

24.10 Për këtë arsye, këto të ardhura nuk do të konsiderohen si burim i ligjshëm për asnjë lloj pasurie, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash*, shtesa të tjera likuiditetesh, pasuri dhe për të mbuluar shpenzimet gjatë periudhës 2005 – 2016, pasi kanë rezultuar me balancë negative -15,253,787 lekë.

24.11 Komisioni gjen me vend të shpjegojë lidhur me konstatimin e tij në rezultatin e hetimit se *“Sikurse konstatohet nga deklaratimet e subjektit, gjendja cash e deklaruar në datën 31.12.2010 është 2,000,000 lekë dhe 10,800 euro, shumë kjo e mjaftueshme për të mbuluar vlerën e përdorur për shlyerjen e kredisë prej 1,500,000 lekësh dhe 1,100 euro”*, është edhe paragrafi i mëposhtëm i rezultateve, ku Komisioni është shprehur edhe për ligjshmërinë e këtyre kursimeve në gjendje *cash* të deklaruara, të cilat për shkak të balancave negative të analizës financiare në vitet 2005 – 2010 nuk mund të shërbejnë si një burim i ligjshëm për mbylljen e kredisë në vitin 2011.

24.12 Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës.

25. Automjet tip “Mercedes-Benz CDI”, me targë *, regjistruar në emër të bashkëshortit.** Blerë në datën 29.4.2009, me nr. *** rep. Vlera: 1,450,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. **Burimi i krijimit:** Të ardhura nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, në datën 15.10.2009, në shumën 900,000 lekë, sipas kontratës nr. *** rep., si dhe kursimet nga pagat e përbashkëta (deklaruar edhe nga bashkëshorti i subjektit).

25.1 Referuar dokumentacionit që subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, rezultoi se: (i) Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 15.11.2002, shtetasi P.B ka blerë nga pronari M.K automjetin tip “Mercedes-Benz” me targë ***, viti prodhimi 1993, në vlerën 250,000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 5.10.2009, ia ka shitur blerësit A.B në vlerën 900,000 lekë; (ii) Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 29.4.2009, shtetasi P.B ka blerë nga pronari L.O automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targë ***, vit prodhimi 2004, nr. shasie ***, në vlerën 1,450,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Deklarimet e subjektit në deklaratat periodike

25.2 Në DIPP-në e vitit 2003: *“Autoveturë në vlerën 250,000 lekë. Pjesa që zotëron: 25%. Burimi i krijimit: Blerë me kursimet e familjes. Të ardhura vjetore 750,000 lekë”*.

25.3 Në DIPP-në e vitit 2009: *“Blerje makine tip “Mercedes-Benz” ML 270 CD (prodhim i vitit 2004) me vlerë 1,450,000 lekë dhe shitje makine tip “Mercedes-Benz” 250 D në vlerën 700,000 lekë”*.

Hetimi i Komisionit

25.4 Nga hetimi³⁹ nuk rezultoi ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasve L.O e M.K.

25.5 Sipas DPSHTRR-së⁴⁰, shtetasi P.B ka në pronësi automjetin me targë *** (ish-targë ***), të cilin e ka blerë me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 29.4.2009, nga ish-pronari L.O, në vlerën 1,450,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

25.6 Sipas DPSHTRR-së⁴¹, shtetasi P.B figuron pronar i automjetit me targë ***, blerë me kontratën datë 15.11.2002. Shtetasi M.K (shitësi) e ka zhdoganuar⁴² automjetin me vlerë totale 430,281 lekë (200,000 lekë çmimi i blerjes + 230,281 taksa zhdoganimit).

25.7 Pra, në kontratën e shitjes datë 15.11.2002, shtetasi P.B e ka blerë automjetin me targë *** me çmimin 250,000 lekë, që është më i lirë sesa vlera reale e tij, 430,281 lekë.

25.8 Referuar deklaratës *Vetting* të subjektit, datë 29.4.2009, kur shtetasi P.B blen automjetin tip “Daimler Chrysler” me vlerë 1,450,000 lekë dhe datë 5.10.2009 kur shtetasi P.B ka shitur automjetin me targë ***, duket se të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit me targë *** në datën 5.10.2009 nuk mund të kenë shërbyer si burim pjesor për blerjen e automjetit me targë *** në datën 29.4.2009.

25.9 Për këtë situatë, në pyetësin standard⁴³ subjekti ka deklaruar: *“Autovetura tip “Mercedes-Benz”, ML 270 CDI, është blerë në datën 29.4.2009, me nr. kontrate ***, në vlerën 1,450,000 lekë. Burimi i të ardhurave është shitja e mjetit tip “Mercedes-Benz 250D” në datën 20.4.2009, por noteria e bërë në datën 15.10.2009 (për arsye shëndetësore të blerësit), me nr. kontrate ***, me vlerën 900,000 lekë + 550,000 lekë të ardhura nga pagat dhe likuidet në shtëpi. Pagesa e çmimit është bërë cash”.*

25.10 Arsyet shëndetësore që subjekti deklaroi për të justifikuar kryerjen e veprimit juridik të shitjes 6 muaj pas zhveshjes nga posedimi faktik i automjetit, nuk janë bindëse. Nga sistemi TIMS rezultoi se subjekti dhe familja e saj kanë dalë dhe hyrë me automjetin me targë *** deri në datën 24.12.2008. Nga sistemi AMF rezultoi se për këtë automjet është prerë policë sigurimi me periudhë vlefshmërie nga data 16.9.2009 – 15.9.2010 nga pronari P.B, pra 6 muaj pas datës 20.4.2009, që subjekti e pretendon si datë kur ka shitur këtë automjet. Noterja I.P konfirmon⁴⁴ kontratën e shitjes së automjetit me targë ***, e cila është lidhur në datën 5.10.2009. Sipas certifikatës së pronësisë datë 19.5.2009, shtetasi P.B figuron pronar i automjetit me targë ***.

³⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 24.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

⁴⁰ Me shkresat nr. *** prot., datë 9.8.2017 dhe nr. ***, datë 10.10.2017, të DPSHTRR-së, në dosjen *Vetting* (aneksi nr. 31).

⁴¹ Shkresa nr. *** prot., datë 23.4.2024 dhe dokumentacioni përkatës në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 11.4.2024, të Komisionit.

⁴² Sipas aktit të zhdoganimit datë 7.9.2002.

⁴³ Përgjigja nr. 9 e pyetësorit standard.

⁴⁴ Shkresa datë 6.5.2024 e noteres I.P.

25.11 Këto fakte më lart provojnë se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka pasur në pronësi dhe në posedim këtë automjet deri në datën e shitjes 5.10.2009 sipas kontratës dhe jo deri në datën 20.4.2009, e pretenduar nga subjekti si datë e shitjes së automjetit.

25.12 Në pyetësin nr. 2, subjekti ka dhënë shpjegim tjetër⁴⁵, duke deklaruar se meqë shitja dhe blerja e automjeteve është bërë brenda të njëjtit vit kalendarik dhe deklarimi i blerjes së automjetit, si dhe i të ardhurave të fituara nga shitja është bërë brenda 3 muajve, pasi ka përfunduar periudha 12-mujore, për të cilën duhej bërë deklarimi, subjekti është mjaftuar me deklarimin e blerjes së automjetit të ri dhe shitjes së automjetit të mëparshëm në deklarimin periodik, pa bërë sqarime të detajuara, sikurse i është kërkuar në pyetësor, pasi sipas deklarimit mjafton të deklarosh pasurinë dhe burimin e të ardhurave për vënien e saj, por pa bërë historikun e burimit të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas datave apo muajve përkatës. Mospërputhja e datës së shitjes dhe asaj të blerjes së automjetit nëpër kontrata ka ardhur sepse automjeti është lënë për t'u shitur në pikat e shitjes së automjeteve, meqë bashkëshorti i njëjtit pronarët e këtyre pikave dhe këta kanë garantuar shitjen e këtyre automjeteve, duke i vlerësuar ato dhe duke i dhënë paraprakisht shumën përkatëse me të cilën kanë blerë automjetin tjetër. Pas gjetjes së personit blerës të automjetit, bashkëshorti është njoftuar dhe është paraqitur së bashku me blerësin para noterit për të lidhur kontratat përkatëse. Në kontratën e shitjes është deklaruar se “Pagesa është marrë nga shitësi paraprakisht jashtë zyrës noteriale”.

25.13 Veprimi i subjektit, që ka dhënë në pyetësin nr. 2 shpjegime të ndryshme nga ato të pyetësorit standard, vë në dyshim vërtetësinë e këtyre shpjegimeve në përpjekjet e saj për të justifikuar mospërputhjen e datave të kontratave të trajtuara më lart.

25.14 Gjatë hetimit rezultoi se automjeti me targë *** është shitur me vlerë më të lartë sesa është blerë, si dhe se ka mospërputhje të vlerës së shitjes së automjetit me targë *** të deklaruar 700,000 lekë në DIPP-në e vitit 2009 dhe vlerës 900,000 lekë të pasqyruar në kontratën e shitjes.

25.15 Për këtë, subjektit iu kërkuar të japë shpjegime dhe të shpjegojë e provojë me dokumentacion ligjor përmirësimet e automjetit, të cilat kanë ndikuar në shitjen e tij me një vlerë më shumë se 3-fishi, pavarësisht se me kalimin e 7 viteve automjeti është amortizuar dhe vjetruar.

25.16 Në përgjigje⁴⁶, subjekti ka shpjeguar: *“Bashkëshorti si shofer prej 47 vitesh dhe i apasionuar pas makinave, është prirur gjithmonë që të gjejë automjete me defekte të lehta teknike e estetike dhe me vlerë të ulët, që me kalimin e kohës sipas rastit t'i riparojë, prandaj vlera e automjetit është rritur në mënyrë graduale, duke investuar në komoditetin dhe në paraqitjen e tij. Përmirësimet e automjetit janë shtrirë ndër vite dhe vlera e përmirësimeve në një vit të vetëm ka qenë më e vogël sesa vlera e shpenzimit të deklarueshëm në deklaratën periodike të pasurisë. Shitja e automjetit me targë *** në fillim është bërë në vlerën 700,000 lekë, por në kontratë është dokumentuar shuma 900,000 lekë, sepse blerësi kërkoi shërbime shtesë, si disqe, goma, veshje të sediljeve etj., shërbime këto, të cilat e rrisnin vlerën e automjetit. Shuma u korrigjua nga 700,000 lekë në 900,000 lekë në kontratë brenda të njëjtës ditë, sepse blerësi nuk dëshironte të paguante sërish për anulim kontrate dhe për kontratë të re, ndaj u korrigjua kontrata ekzistuese fillimisht*

⁴⁵ Përgjigjja nr. 9 e pyetësorit nr. 2.

⁴⁶ Me pyetësin nr. 2.

me shkrim dore mbi të dhe pastaj kontrata u shtyp nga e para me shumën e korrigjuar (kjo e lejuar sipas ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”). Sipas shpjegimeve të noteres, kjo nuk është kontratë e re, por korrigjim i kontratës së mëparshme”.

25.17 Subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor as rritjen e vlerës së automjetit në shumën 700,000 lekë, që pretendoi se është shpërndarë ndër vite, dhe as rritjen në vlerën 900,000 lekë, që pretendoi se e ka bërë brenda një dite në datën e lidhjes së kontratës.

25.18 Gjithashtu, nga shitjet e mëpasme të këtij automjeti⁴⁷ ka rezultuar se jo vetëm pas çdo shitjeje vlera e automjetit vjen duke u ulur, por midis çmimit kontraktor 900,000 lekë, me të cilin e ka shitur automjetin shtetasi P.B dhe çmimeve 140,000 lekë e 100,000 lekë, që e kanë shitur automjetin pronarët e tjerë më pas, ka diferencë të madhe.

25.19 Këto rrethana krijojnë dyshimin e arsyeshëm se çmimi i shitjes së automjetit me targë ***, i vendosur në kontratën e shitjes, është fiktiv dhe është bërë me qëllim për të justifikuar burimin e krijimit të automjetit me targë ***.

Analiza e burimit të krijimit të automjetit me targë ***

25.20 Në lidhje me burimin e krijimit të automjetit objekt shqyrtimi, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting “Të ardhura nga shitja e automjetit “Mercedes-Benz” me targë ***, në vlerën 900,000 lekë dhe kursimet nga pagat”*, por në pyetësorin standard e ka qartësuar burimin duke i shtuar deklaratimit edhe *“...550,000 lekë të ardhura nga pagat dhe likuidet në shtëpi. Mënyra e pagimit u bë cash”*.

25.21 Nisur nga këto dy burime krijimi, Komisioni analizoi: (i) mundësinë e subjektit për të krijuar pasurinë automjet me targë ***, në vlerën 250,000 lekë, pasuri nga shitja e së cilës krijoi të ardhurat në vlerën 900,000 lekë; (ii) mundësinë e krijimit të kursimeve “likuidet në shtëpi në vlerën 550,000 lekë nga pagat e përbashkëta”.

25.22 Nga analiza financiare e mundësisë financiare të subjektit dhe bashkëshortit të saj për të blerë automjetin me targë *** në datën 15.11.2002, në shumën 250,000 lekë, duke përfshirë si burim të ardhurash të ardhurat e dokumentuara gjatë periudhës 14.5.1998 – 2002⁴⁸, si dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të blerë automjetin me targë *** në datën 15.11.2002, për shkak të balancës negative -85,420 lekë⁴⁹.

25.23 Në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit me targë *** në vlerën 900,000 lekë, Komisioni mori në konsideratë si të ardhura të ligjshme shumën 250,000 lekë, pasi nuk u provua me dokument shtesa e vlerës së automjetit, e cila sipas kontratës së shitjes është përfituar në datën

⁴⁷ Me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.10.2014, shtetasi A.B, pronari i automjetit që e bleu nga shtetasi P.B, e ka shitur automjetin me vlerë 150,000 lekë tek blerësi B.P pa pretendime për gjendjen teknike të tij. Me kontratën datë 21.2.2020, B.P e shet automjetin me çmimin 100,000 lekë dhe, sipas certifikatës së kontrollit teknik datë 20.2.2020, automjeti figuron në gjendje të rregullt.

⁴⁸ Analiza financiare është kryer e fragmentuar duke filluar nga 14.5.1998, pasi para kësaj periudhe subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme. Për më shumë detaje shihni analizën në formatin *Excel*.

⁴⁹ Pasuritë 250,000 lekë (automjet me targë ***, blerë në datën 15.11.2002): detyrime 446,248 lekë; të ardhurat 2,320,826 lekë (të ardhurat nga paga e subjektit 2,070,826 lekë + të ardhura nga shitja e automjetit BMW në datën 23.10.2002 (deklaruar në pyetësorin standard) 250,000 lekë); shpenzimet 1,709,998 lekë (shpenzime jetike 1,432,696 lekë + shpenzime mobilimi 277,302 lekë) = mundësia për kursime -85,420 lekë.

5.10.2009, rreth 6 muaj pas blerjes së automjetit me targë *** në datën 29.4.2009 dhe, si e tillë, nuk mund të ketë shërbyer si burim për krijimin e automjetit me targë ***.

25.24 Në lidhje me likuiditetet në shtëpi në vlerën 550,000 lekë, të deklaruara në deklaratën *Vetting* si burim krijimi, Komisioni konstatoi se subjekti ka deklaruar kursime *cash* 500,000 lekë në vitin 2008, por në DIPP-në e vitit 2009, vitin kur është blerë automjeti, nuk ka deklaruar as pakësim të gjendjes *cash* dhe as burim krijimi për blerjen e automjetit me targë *** “kursimet *cash*”. Por, pavarësisht kësaj, edhe nëse Komisioni do ta konsiderojë këtë gjendje *cash* si burim të mundshëm, nga analiza financiare e vitit 2008 subjekti ka rezultuar me një balancë negative - 611,903 lekë, e cila cenon ligjshmërinë e gjendjes *cash* të dekluarar.

25.25 Nga analiza financiare për verifikimin e mundësisë së subjektit dhe bashkëshortit të saj për të blerë automjetin me targë *** në shumën 1,450,000 lekë, duke përfshirë si burim të ardhurat e dokumentuara gjatë periudhës 1.1.2009 – 29.4.2009, si dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mundësi që të blejë me të ardhura të ligjshme automjetin me targë *** në datën 29.4.2009, për shkak të balancës negative prej -1,286,527 lekësh⁵⁰.

25.26 Sa më sipër, Komisioni i ngarkoi subjektin të rivlerësimin barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, që duket se:

- a) Subjekti i rivlerësimin ka mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -1,286,527 lekë për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” me targë ***, në datën 29.4.2009.
- b) Subjekti i rivlerësimin ka bërë deklarin të rremë në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit me targë *** në datën 15.10.2009 si burimi i krijimit të pasurisë automjet me targë ***, pasi ky burim nuk ka ekzistuar në momentin e krijimit të kësaj pasurie datë 29.4.2009.
- c) Subjekti i rivlerësimin ka bërë deklarin fiktiv të çmimit të blerjes së pasurisë automjet me targë ***, pasi në kontratën e shitblerjes datë 15.11.2002 të këtij automjeti çmimi i blerjes 250,000 lekë është pasqyruar më lirë sesa vlera reale prej 430,281 lekësh, veprim ky që nuk ka logjikë ekonomike.
- d) Subjekti i rivlerësimin ka bërë deklarin fiktiv të çmimit të shitjes së pasurisë automjet me targë ***, pasi në kontratën e shitjes datë 5.10.2009 është pasqyruar çmimi 900,000 lekë, megjithëse ky automjet është blerë dyfish më lirë dhe është përdorur për 7 vjet.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimin

25.27 Subjekti ka kundërshtuar barrën e provës për konstatimin e parë, duke shpjeguar se nuk ka mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -1,286,527 lekë për blerjen e automjetit me targë ***, në datën 29.4.2009, duke sjellë argumentet se në DIPP-në e vitit 2008, krahas pagës së saj ka deklaruar edhe pagën e bashkëshortit prej 336,000 lekësh dhe dieta mesatare të bashkëshortit prej

⁵⁰ Pasuritë 1,541,560 lekë (automjet me targë *** , blerë në datën 29.4.2009 + shtesa /pakësime të likuiditeteve 91,560 lekë): likuiditete në banka 6,936,164 lekë; *cash* deklaruar në DPV 500,000 lekë; gjendja e likuiditeteve 7,436,164 lekë; detyrime 226,688 lekë (pagesë kësti); pasuri neto (pasuri - detyrime) 1,768,248 lekë; të ardhurat 659,704 lekë (të ardhurat nga paga e subjektit 423,032 lekë + të ardhurat nga paga e bashkëshortit 92,256 lekë + të ardhura nga interesat bankarë 144,416 lekë); shpenzimet 177,984 lekë (shpenzime jetike 182,160 lekë + *zbritur shpenzimet jetike për bashkëshortin UP 4,866 lekë + shpenzime TIMS 690 lekë) = mundësia për kursime 1,286,527 lekë.

5,760 euro, ndërsa në fund të vitit 2008 ka deklaruar gjendje *cash* 500,000 lekë. Këto të ardhura janë të mjaftueshme për të justifikuar çmimin e blerjes së automjetit me targë ***.

25.28 Subjekti ka shpjeguar se nuk ka bërë deklaram të rremë në lidhje me të ardhurat nga shitja e automjetit me targë *** në datën 15.10.2009 si burimi i krijimit të pasurisë automjet me targë ***. Në deklaratën periodike, deklarimi i pasurisë bëhet në fillim të vitit pasardhës. Subjekti ka deklaruar pasuritë dhe burimin e të ardhurave, megjithëse mund të ketë pasaktësi në mënyrën se si është deklaruar në rend kronologjik burimi i të ardhurave, por automjeti me targë *** është shitur brenda periudhës së deklaramit. Gjendja e kursimeve e deklaruar në fund të çdo viti provon se subjekti ka disponuar të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit me targë *** edhe pa përfshirë në datën përkatëse të blerjes vlerën e shitjes së automjetit që ka shitur në atë vit.

25.29 Subjekti ka shpjeguar se nuk ka bërë deklaram fiktiv të çmimit të blerjes së automjetit me targë ***. Ky automjet është blerë në vlerën 250,000 lekë, sikurse provon kontrata e shitjes datë 15.11.2002. Komisioni padrejtësisht konkludon që vlera reale e këtij automjeti është 430,281 lekë, aq sa është blerë më parë nga shitësi M.K, duke argumentuar se veprimi i blerjes së këtij automjeti në vlerën 250,000 lekë nuk ka logjikë ekonomike. Subjekti e konsideron të padrejtë që i kërkohet të shpjegojë përse shitësi e ka shitur automjetin me vlerën 250,000 lekë, edhe pse është provuar që subjekti nuk është në konflikt interesi me këtë shtetas. Subjekti kërkoi të mos ngarkohet me përgjegjësi administrative për një fakt të tillë.

25.30 Subjekti ka shpjeguar që Komisioni konkludon padrejtësisht se ajo ka bërë deklaram fiktiv të çmimit të shitjes së pasurisë automjet me targë ***, pasi në kontratën e shitjes datë 5.10.2009 është pasqyruar çmimi 900,000 lekë, pavarësisht se ky automjet është blerë dyfish më lirë dhe është përdorur 7 vjet. Në lidhje me shtimin e vlerës së automjetit, nëpërmjet kryerjes së shërbimeve në servise, shërbimet nuk janë kryer në një vlerë të vetme dhe çdo vlerë nuk e kalon 300,000 lekë/vit, prandaj meqë nuk ka qenë i detyrueshëm deklarimi i kësaj vlere shpenzimi dhe meqë nuk është ruajtur dokumentacion për vlerën e shërbimeve, subjekti nuk mund të provojë kryerjen e shpenzimit për shtimin e vlerës së automjetit. Subjekti nuk ka mundur as të marrë kopje të faturës së shërbimit të riparimit të automjetit pranë subjektit tatimpagues, ku është kryer shërbimi në vitin 2009, pasi ka kaluar afati maksimal ligjor 10 vjet i ruajtjes së dokumentacionit financiar.

Vlerësimi i Komisionit

25.31 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se subjekti në prapësime ka dhënë të tjera burime krijimi për automjetin me targë *** dhe nuk i përmend më të ardhurat nga shitja e automjetit me targë *** si burim krijimi.

25.32 Në analizën e kryer nga Komisioni në rezultatet e hetimit, ndryshe nga sa pretendon subjekti, janë përfshirë të ardhurat nga paga e bashkëshortit deri në datën e blerjes së automjetit, të ardhura këto të provuara me dokumentacion ligjor dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Në lidhje me përfshirjen e dietave si të ardhura, Komisioni, ashtu sikundër ka konstatuar edhe në rezultatet e hetimit, nuk mund t'i konsiderojë ato si të ardhura të ligjshme, pasi nuk plotësojnë kriteret e nenit 3 të pikës D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ato kanë destinacion mbulimin e shpenzimeve gjatë udhëtimeve të punës. Gjithashtu, Komisioni është shprehur në rezultatet e hetimit edhe në lidhje me moskonsiderimin e kursimeve *cash* në vlerën 500,000 lekë

të deklaruara në DIPP-në e vitit 2008 si burim për blerjen e automjetit. Subjekti në prapësime nuk ka paraqitur asnjë provë të re dhe argument ligjor lidhur me pretendimet e tij.

25.33 Në lidhje me kundërshtimet e subjektit ndaj konstatimit se subjekti ka bërë deklaram të rremë për të ardhurat nga shitja e automjetit me targë *** në datën 15.10.2009 si burim i krijimit të pasurisë automjet me targë ***, pasi ky burim nuk ka ekzistuar në momentin e krijimit të kësaj pasurie datë 29.4.2009, Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti nuk janë bindëse, pasi të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit me targë *** në datën 15.10.2009, logjikisht nuk mund të shërbejnë për të krijuar pasurinë automjet me targë *** në datën 29.4.2009, pra 6 muaj më parë.

25.34 Më tej, prapësimi i subjektit se gjendja e kursimeve të deklaruara në fund të çdo viti provon se ai ka disponuar të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit me targë *** edhe pa përfshirë në datën përkatëse të blerjes vlerën e shitjes së automjetit që ka shitur në atë vit, në vlerësimin e Komisionit jo vetëm vë në dyshim për të disatën herë vërtetësinë e çdo deklarimi e shpjegimi që subjekti ka bërë në lidhje me burimet e krijimit të automjetit me targë ***, por tregon pasigurinë që tashmë subjekti ka për provueshmërinë bindëse të burimit “të ardhura nga shitja e automjetit me targë ***”, që e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësin standard.

25.35 Në lidhje me shpjegimet e subjektit në prapësime se ajo nuk ka bërë deklaram fiktiv të çmimit të blerjes së automjetit me targë *** dhe se ky automjet është blerë me vlerë 250,000 lekë, Komisioni vlerëson se argumentet e dhëna nga subjekti nuk janë bindëse dhe i qëndron argumentimit se logjikisht një automjet në gjendje të mirë teknike nuk mund të shitet dyfish më pak se vlera me të cilën është blerë 2 muaj më parë nga një person me të cilin subjekti apo bashkëshorti i saj në cilësinë e blerësit nuk kanë asnjë lidhje, njohje apo konflikt tjetër interesi.

25.36 Në lidhje me shpjegimet e subjektit se nuk ka bërë deklaram fiktiv të çmimit të shitjes së automjetit me targë *** dhe në kontratën e shitjes datë 5.10.2009, është pasqyruar çmimi real 900,000 lekë, por nuk mund të provojë shtimin e vlerës së automjetit, Komisioni vlerëson se argumentet që sjell subjekti nuk janë bindëse. Pavarësisht se ka kaluar afati 10-vjeçar i ruajtjes së dokumentacionit financiar që provon shpenzimet e kryera nga subjekti pranë serviseve për t’i rritur vlerën automjetit, subjekti nuk depozitoi asnjë dokumentacion nga këto servise, që të konfirmojnë se nuk kanë ruajtur një dokumentacion të tillë. Nga ana tjetër, ndonëse subjekti nuk kishte detyrimin ligjor të deklaronte në vitin 2009 shpenzimin vjetor më të vogël se 300,000 lekë, që pretendon se ka kryer çdo vit për t’i shtuar vlerën automjetit me targë *** dhe, për këtë arsye, nuk ka ruajtur dokumentacionin që provon këtë shpenzim, vlen të theksohet se ky nuk është një shpenzim i veçuar, por është një shpenzim që i rrit vlerën pasurisë dhe, për këtë, në formularin e deklarimit të pasurisë të vitit 2009 është përcaktuar qartë detyrimi i subjekteve deklaruuese që të deklarojnë shtesat e pakësimet e pasurive. Mosdeklarimi ndër vite i vlerës së shtuar të pasurisë automjet me targë *** dhe mungesa e dokumentacionit provues e bën të pamundur provueshmërinë e kësaj vlere të automjetit. Nëse shtojmë këtu edhe rrethanat e tjera të konstatuara nga Komisioni gjatë hetimit, si: shitja e këtij automjeti 6 muaj pas blerjes së automjetit me targë ***; shitja e automjetit me targë *** me çmim shumë më të lartë sesa çmimi me të cilin e kanë shitur më pas pronarët pasardhës; shpjegimet kontradiktore të subjektit gjatë hetimit administrativ në lidhje me datat e shitjes së automjetit me targë ***, atëherë të ardhurat nga shitja e këtij

automjeti në vlerën 900,000 lekë që pretendon subjekti, jo vetëm që bëhen të diskutueshme, por përforcohet dyshimi i arsyeshëm se çmimi i shitjes së automjetit me targë ***, i vendosur në kontratën e shitjes, është fiktiv dhe është bërë me qëllim për të justifikuar burimin e krijimit të automjetit me targë ***.

25.37 Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës.

26. Automjet tip “Citroen C3”, me targë *, regjistruar në emrin personal, blerë në datën 15.6.2012, me nr. *** rep. Vlera: 13,500 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit:** Një pjesë nga të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf” me targë ***, sipas kontratës nr. *** rep., datë 19.6.2012, në vlerën 6,000 euro, si dhe kredisë *leasing* pranë Credins Bank në datën 15.6.2012, me nr. kontrate ***, në vlerën 8,181 euro. Kredia është në proces shlyerjeje.

Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave fizikë e juridikë” të deklaratës *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Kredi leasing e marrë pranë Credins Bank, dega Elbasan, në datën 19.6.2012, në shumën 8,181 euro. Deri në datën 24.1.2017, shuma e mbetur pa shlyer 830 euro*”.

Deklarimet e subjektit në deklaratat periodike

26.1 Në DIPP-në e vitit 2008: “*Blerje makine tip “Volkswagen” 1.6 në vlerën 250,000 lekë*”.

26.2 Në DIPP-në e vitit 2012: “*Kredi në vlerën 8,181 euro, e marrë tek Credins Bank për blerje makine tip “Citroen C3”, vlera e saj 13,500 euro në total, e blerë me kredi dhe një pjesë nga shitja e makinës tip “Volkswagen” 6,000 euro*”.

26.3 Në DIPP-në e viteve 2013, 2014 dhe 2015 ka deklaruar shlyerjen e kredisë për blerjen e automjetit tip “Citroen C3”, në vlerat përkatëse për çdo vit 2,405 euro, 2,310 euro dhe 2,261 euro.

26.4 Në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar se deri në datën 31 dhjetor shuma e shlyer e kredisë për blerje automjeti është 7,351 euro dhe detyrimi i mbetur pa u shlyer është 2,239.71 lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

26.5 Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *Vetting*⁵¹, si dhe nga dokumentacioni i administruar⁵² gjatë hetimit, ka rezultuar se:

26.6 Në datën 20.11.2007, pronari I.E ka zhdoganuar automjetin e tij “Volkswagen Golf 1.6” me targë ***, vit prodhimi 1998, me vlerë totale 333,450 lekë. Në datën 26.9.2008, shtetasi I.E ia shet këtë automjet në vlerën 250,000 lekë subjektit të rivlerësimit, i cili sipas certifikatës së pronësisë datë 27.1.2009 figuron pronar i tij. Në datën 5.6.2012, subjekti i rivlerësimit ia shet këtë automjet në vlerën 6,000 euro, likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale, blerësve F dhe A.XH.

⁵¹ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.9.2008, automjeti me targë ***; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.6.2012, automjeti me targë ***; plani i pagesave të qirasë financiare (*leasing*) datë 15.6.2012; vërtetim datë 24.1.2017 nga Credins Bank.

⁵² Me postën elektronike datë 30.1.2020 të DPSHTRR-së, në dosjen *Vetting*; me shkresën përcjellëse nr. *** prot., datë 23.4.2024, të DPSHTRR-së, në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 11.4.2024, të Komisionit; me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021, të ILDKPKI-së; dokumentacioni i depozituar nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

26.7 Sipas deklaratës doganore datë 24.4.2012, automjeti tip “Citroen C3” me targë *** është zhdoganuar me vlerë totale 1,623,773.8 lekë⁵³. Në datën 15.6.2012 lidhet kontrata e shitblerjes me blerës Credins Leasing, shitës “****” sh.p.k. dhe porositëse Rajmonda Berisha, për blerjen e këtij automjeti në vlerën 13,500 euro. Automjetin e ka përfituar pala qiradhënëse Credins Leasing nëpërmjet faturës së blerjes nr. ***, datë 15.6.2012, nga “****” sh.p.k., në vlerën 13,500 euro. Me certifikatë pronësie datë 15.6.2012, ky automjet figuron në emër të Credins Leasing, e cila me autorizimin e datës 19.6.2012, në cilësinë e pronarit qiradhënësi të automjetit, autorizon subjektin dhe bashkëshortin e saj që ta përdorin këtë automjet brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Në datën 20.6.2017 lidhet kontrata me palë kontraktore Credins Bank dhe palë blerëse Rajmonda Berisha, me qëllim shitblerjen e automjetit me vlerën 1 euro. Kjo kontratë është lidhur në bazë të kontratës së qirasë financiare datë 19.6.2012, me të cilën shitësi (qiradhënësi) Credins Leasing ka financuar blerësin (qiramarrësin) Rajmonda Berisha për automjetin tip “Citroen”.

26.8 Sipas plan pagesave të qirasë financiare (leasing) datë 15.6.2012, në Credins Leasing, me palë qiramarrëse Rajmonda Berisha, për blerjen e automjetit tip “Citroen” në vlerën totale 13,500 euro, janë parapaguar 5,319 euro dhe shuma e financimit është 8,181 euro, me afat 60 muaj deri në datën 10.6.2017, të përfundimit të kontratës.

26.9 Sipas vërtetimit datë 13.3.2015 nga Credins Bank, subjekti për shlyerjen e kredisë *leasing* për blerje automjeti, ka paguar për vitin 2014 shumat 2,309 euro dhe 16,950 lekë (në total 340,223 lekë) dhe detyrimi i mbetur në fund të vitit 2014 është 4,547 euro ose 636,585 lekë.

26.10 Sipas pasqyrës datë 24.2.2016 nga Credins Bank për pagesat e kësteve *leasing*, subjekti ka paguar për të gjithë vitin 2015 vlerën totale 2,261.53 euro dhe vlera e mbetur në datën 31.12.2015 është 2,849 euro.

26.11 Sipas vërtetimit datë 24.1.2017 nga Credins Bank, subjekti ka marrë kredi *leasing* në datën 19.6.2012, në shumën 8,181 euro dhe detyrimi i mbetur në datën 24.1.2017 është 830 euro.

26.12 Sipas vërtetimit datë 19.3.2018 nga Credins Bank, kredia në vlerën 8,181 euro që subjekti ka marrë për blerje automjeti, është mbyllur totalisht në datën 22.6.2017.

26.13 Nga hetimi⁵⁴ nuk rezultoi ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit I.E e shoqërisë “Credins Leasing” sh.a.

26.14 Referuar deklaramentit *Vetting* të subjektit dhe datave të kontratave, duket se subjekti nuk ka deklaruar saktë datën 19.6.2012 të kontratës datë 5.6.2012, me të cilën ka shitur automjetin tip “Golf” me targë ***, por këtë gabim e ka korrigjuar në pyetësorin standard⁵⁵, ku ka deklaruar: “*Citroen C3, blerë në datën 19.6.2012, me nr. kontrate ***, në vlerën 13,500 euro. Burimi i të ardhurave: kredi në Credins Bank, leasing, me datë 15.6.2012, nr. kontrate ***, në vlerën 8.181 euro; shitja e autoveturës tip “Golf 1.6” në datën 5.6.2012, në vlerën 6,000 euro, me nr. kontrate *** rep., nr. *** kol. Mënyra e pagimit u bë kredi + cash*”.

⁵³ Dosja *Vetting*, aneks nr. 31 (vlera e blerjes së automjetit 9,610 euro ose 1,349,051.8 lekë + 274,722 lekë taksa zhdoganimi = 623,773.8 lekë).

⁵⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 24.4.2024, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

⁵⁵ Përgjigjja nr. 9 e pyetësorin standard.

Analiza e mundësisë së krijimit të automjetit tip “Citroen C3”

26.15 Në lidhje me burimin e krijimit të automjetit tip “Citroen C3”, subjekti ka deklaruar dy burime krijimi: (i) vlera 6,000 euro nga shitja e automjetit tip “Golf” me targë ***; (ii) financimi me *leasing* në datën 19.6.2012, në shumën 8,181 euro. Për këtë arsye Komisioni analizoi: (i) mundësinë e subjektit për të krijuar pasurinë automjet tip “Golf” me targë ***, në vlerën 250,000 lekë dhe mundësinë për të krijuar vlerën 6,000 euro nga shitja e tij; (ii) financimin me *leasing* në datën 19.6.2012, në shumën 8,181 euro, si dhe mundësinë e shlyerjes së kësaj vlere.

26.16 Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Golf” me targë ***, në shumën 6,000 euro, në datën 5.6.2012, përdorur si burim për blerjen e automjetit tip “Citroen”, me pyetësorin nr. 2 subjektit iu kërkua të shpjegojë e provojë me dokumentacion ligjor përmirësimet e mjetit, të cilat kanë ndikuar në shitjen e tij me vlerë më shumë se 3-fishi i vlerës së blerjes, pavarësisht se pas 4 vitesh mjeti është amortizuar dhe vjetruar.

26.17 Subjekti në përgjigje⁵⁶ ka dhënë të njëjtat shpjegime si në pikën 25.16 më lart, se bashkëshorti i saj gjen mjete me defekte të lehta teknike dhe estetike që kanë vlerë të ulët dhe i riparon gradualisht duke i rritur komoditetin dhe paraqitjen e tyre. Përmirësimet e mjetit janë shtrirë ndër vite dhe vlera e tyre në një vit të vetëm nuk ka qenë më e madhe se vlera e shpenzimit të kërkuar për t’u deklaruar në deklarinimin periodik të pasurisë.

26.18 Gjatë hetimit ka rezultuar se në vitin 2007, vlera e automjetit tip “Golf” me targë ***, në pronësi të shtetasit I.E, ka qenë 333,450 lekë. Në vitin 2008, subjekti e ka blerë këtë automjet nga shtetasi I.E në vlerën 250,000 lekë dhe në vitin 2012 ia shet blerësve F e A.XH në vlerën 6,000 euro (837,540 lekë), ose rreth 3.3 herë më shumë sesa çmimi i blerjes, edhe pse automjeti është vjetruar me 4 vjet. Në vitin 2014, shtetasi F e A.XH ia shesin këtë automjet shtetasit M.P në vlerën 400,000 lekë, pra dyfish më pak se vlera që e kanë blerë. Shtetasi M.P e shet automjetin në vitin 2015, në vlerën 250,00 lekë.

26.19 Pra, veprimi i kryer nga subjekti duke shitur në vitin 2012 në çmimin 6,000 euro automjetin e blerë para 4 vitesh me çmim 250,000 lekë, nuk ka logjikë ekonomike krahasuar me transaksionet e kryera para dhe pas veprimit të blerjes. Ky veprim i subjektit, duke i shtuar edhe faktin që ai nuk e provoi shtimin e vlerës së automjetit me targë ***, ngre dyshime se është kryer me qëllim justifikimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë automjet tip “Citroen C3”.

26.20 Meqë subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor shtesën e vlerës së këtij automjeti, atëherë në analizën financiare është përfshirë si e ardhur nga shitja e automjetit tip “Golf” vlera 250,000 lekë dhe jo vlera 6,000 euro.

26.21 Nga analiza financiare e shtrirë në periudhën 1.1.2008 – 26.9.2008, për të provuar mundësinë e blerjes së automjetit me targë *** në vlerën 250,000 lekë, në datën 26.9.2008, rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme, për shkak të balancës negative prej - 97,619 lekësh⁵⁷.

⁵⁶ Përgjigjja nr. 8 e pyetësorit nr. 2.

⁵⁷ Pasuritë 17,272 lekë (shtesa/pakësime të likuiditeteve 267,272 lekë - automjet tip “Volkswagen Golf” me targë ***, datë 26.9.2008, 250,000 lekë); gjendja e likuiditeteve 6,892,624 lekë (likuiditete në banka 6,492,624 lekë + *cash*, deklaruar në DPV 400,000 lekë); detyrime 312,199 lekë (pagesë kësti (principal + interes); pasuri neto (pasuri -

26.22 Në lidhje me financimin me leasing, ka rezultuar se në zbatim të kontratës së qirasë financiare datë 15.6.2012, subjekti, si qiramarrës i automjetit tip “Citroen”, për çmimin e blerjes 13,500 euro ka parapaguar 5,319 euro, ndërsa për diferencën e vlerës prej 8,181 euro është financuar nga qiradhënësi për një afat 5-vjeçar (10.7.2012 – 10.6.2017), me pagesë mujore 169.82 euro.

26.23 Nga veprimet bankare në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në Credins Bank⁵⁸ rezultoi se për periudhën 11.7.2012 – 23.6.2017 janë paguar periodikisht çdo muaj këstet sipas planit të pagesave, me përshkrimin “Pagesë këst leasing”. Pra, shuma 8,181 euro, që ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “Citroen”, është me burime të ligjshme.

26.24 Në lidhje me mundësinë e subjektit për të shlyer me të ardhura të ligjshme detyrimin e lindur nga kontrata e qirasë financiare (leasing), Komisioni iu referua situatës financiare të subjektit për periudhën 2012 – 2016, periudhë në të cilën janë kryer edhe pagesat e kësteve.

26.25 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve, pasi duket që:

- Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Citroen C3” me targë ***, pasi nuk u provuan të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Golf” me targë ***, në shumën 6,000 euro, në datën 5.6.2012.
- Në kontratën e shitjes datë 5.6.2012 të automjetit tip “Golf” me targë ***, subjekti ka deklaruar çmim fiktiv të shitjes 6,000 euro, pasi nuk u provua vlera e shtuar e këtij automjeti në raport me çmimin e blerjes 250,000 lekë dhe afatin e përdorimit për 4 vjet.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

26.26 Konkluzionin e Komisionit se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Citroen C3” me targë ***, duke mos pranuar që automjeti tip “Golf” me targë *** është shitur në vlerën 6,000 euro, në datën 5.6.2012, edhe pse vlera e shitjes është deklaruar në kontratën e shitjes dhe në DIPP-në e vitit 2012, subjekti e konsideron se është në kundërshtim me parimin e drejtësisë, objektivitetit dhe proporcionalitetit.

26.27 Në prapësimet e barrës së provës, subjekti ka shpjeguar se nuk disponon dokumentacion për të provuar shtimin e vlerës së automjetit tip “Golf” me targë *** nëpërmjet shërbimeve në servis. Shërbimet nuk janë kryer në një vlerë të vetme dhe nuk e kalojnë vlerën 300,000 lekë/vit. Meqenëse shpenzimet në këtë vlerë nuk ka qenë të detyrueshme me ligj që të deklaroheshin, subjekti nuk ka ruajtur dokumentacion për vlerën e shërbimeve dhe nuk mund ta provojë ndryshe.

Vlerësimi i Komisionit

26.28 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se, në lidhje me pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për të provuar shtesën e vlerës së automjetit me

detyrime) 294,927 lekë; të ardhurat 932,374 lekë (të ardhurat nga paga e subjektit 644,571 + të ardhurat nga paga e bashkëshortit 190,278 + të ardhurat nga interesat bankarë 97,525 lekë); shpenzimet 735,066 lekë [shpenzime jetike 409,860 - shpenzimet jetike për bashkëshortin UP 14,598 + shpenzime TIMS 309,804 + shpenzime shkollimi H AL (2003 – 2012) 30,000 lekë] = mundësia për kursime -97,619 lekë.

⁵⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 23.3.2021, e Credins Bank.

targë ***, vlen të theksohet që pavarësisht se subjekti nuk kishte detyrimin ligjor të deklaronte shpenzimin vjetor më të vogël se 300,000 lekë, që pretendon se ka kryer çdo vit për t'i shtuar vlerën automjetit me targë *** dhe, për këtë arsye, nuk ka ruajtur dokumentacionin që provon këtë shpenzim, vlen të theksohet se ky nuk është një shpenzim i veçuar, por një shpenzim në funksion të qëllimit të vetëm për t'i rritur vlerën pasurisë dhe, për këtë, në formularin e deklarimit të pasurisë të vitit 2012 është përcaktuar qartë detyrimi i subjekteve deklaruese që të deklarojnë shtesat e pakësimit e pasurive.

26.29 Mosdeklarimi ndër vite i vlerës së shtuar të pasurisë automjet me targë *** dhe mungesa e dokumentacionit provues, e bën të pamundur provueshmërinë e kësaj vlere të shtuar të automjetit. Nëse shtojmë këtu edhe faktin që shitja e automjetit me targë *** është bërë me çmim shumë më të lartë sesa çmimi me të cilin e kanë shitur më pas pronarët pasardhës, atëherë të ardhurat nga shitja e këtij automjeti në vlerën 6,000 euro, që pretendon subjekti, jo vetëm që bëhen të diskutueshme, por përforcohet dyshimi i arsyeshëm se çmimi i shitjes së këtij automjeti i vendosur në kontratën e shitjes është fiktiv dhe është bërë me qëllim për të justifikuar burimin e krijimit të automjetit me targë ***.

26.30 Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës.

26.31 Për sa trajtuar në pikat 25 dhe 26 më lart, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimeve se duket që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë shfaqur tendencë të përsëritur për të deklaruar çmime fiktive në transaksionet (shitjet dhe blerjet) e automjeteve, me qëllim për të justifikuar mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive. Me këto veprime, subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi çmimet e referuara në kontratat e shitjes, si dhe shpjegimet e saj nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerën reale të transaksioneve.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

26.32 Për të kundërshtuar barrën e provës, subjekti ka shpjeguar pamundësinë për të provuar shtesën e vlerës së automjeteve që ajo ka shitur, trajtuar në të njëjtën mënyrë si më lart për të dyja automjetet.

26.33 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se kontratat e shitblerjes dhe DIPP-të vjetore ku pasqyrohen veprimet e shitblerjes janë prova të pakundërshtueshme. Hetimi i kryer nga Komisioni për shitjen e këtyre mjeteve vite më vonë pas datës kur ato janë shitur nga subjekti, ka treguar se vlera e këtyre mjeteve ka qenë më e lartë se vlera me të cilën ishin blerë nga subjekti. Gjithashtu, nuk mund të jetë kriter matës viti kur është kryer shitja e mjeteve, pa ditur arsyet që kanë çuar në shitblerjen e tyre me atë vlerë (prania e defektit, nevoja për të ardhura etj.).

Vlerësimi i Komisionit

26.34 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se në lidhje me pretendimin e subjektit se kontratat e shitblerjes dhe DIPP-të vjetore ku pasqyrohen veprimet e shitblerjes janë prova të pakundërshtueshme, Komisioni nuk e kundërshton ekzistencën e këtyre akteve juridike në cilësinë e provës, por në kushtet kur ekzistojnë edhe rrethana të tjera

që e vënë mjaftueshëm në dyshim çmimin e deklaruar në këto akte, atëherë vlera provuese e këtyre akteve cenohet në atë masë të konsiderueshme saqë krijojnë bindjen se çmimi i deklaruar është fiktiv.

26.35 Gjithashtu, pretendimi i subjektit në prapësime se nga hetimi ka rezultuar që vlera e këtyre mjeteve në shitjet e mëvonshme pas datës kur janë shitur nga subjekti ka qenë më e lartë se vlera me të cilën ishin blerë këto mjete nga subjekti, nuk është i vërtetë. Nga dokumentacioni i administruar dhe arsyetimi i Komisionit, në mënyrë të qartë, ka rezultuar e kundërta.

26.36 Konkretisht, automjeti me targë *** (të ardhurat nga shitja e të cilit janë përdorur për të krijuar pasurinë automjet me targë ***) është blerë në vlerën 250,000 lekë nga subjekti dhe pasi është shitur nga subjekti me çmimin 900,000 lekë, është shitur më pas nga pronarët e tjerë me çmimet 140,000 lekë dhe 100,000 lekë, pra më pak se çmimi me të cilin e ka blerë subjekti. Ndërsa automjeti tip “Golf” me targë *** (të ardhurat nga shitja e të cilit janë përdorur për të krijuar pasurinë automjet me targë ***), që subjekti e ka blerë në vitin 2008 nga shtetasi I.E, në vlerën 250,000 lekë dhe në vitin 2012 e ka shitur në vlerën 6,000 euro (837,540 lekë), është shitur nga pronarët pasardhës me çmimet 400,000 lekë dhe 250,000 lekë. Vetëm për këtë automjet kemi një rast ku çmimi i shitjes pasardhëse 400,000 lekë është më i lartë se çmimi 250,000 lekë me të cilin subjekti e ka blerë automjetin por, sidoqoftë, çmimi 400,000 lekë është dyfish më i ulët sesa çmimi 6,000 euro (837,540 lekë) që subjekti deklaroi në kontratë, në DIPP-në e vitit 2012 dhe në deklaratën *Vetting*, se e ka shitur automjetin me targë ***.

26.37 Duke shtuar për automjetin me targë *** edhe faktin që vlera e shtuar prej 6,000 euro nuk u provua nga subjekti, vihet në dyshim edhe diferenca në rritje nga 250,000 lekë në 400,000 lekë, për shkak se nuk përjashtohet mundësia që kjo rritje të jetë bërë nga personat që e blenë automjetin prej subjektit dhe nuk është bërë nga vetë subjekti përpara se ta shiste këtë automjet.

26.38 Për sa më lart, asnjë shpjegim i subjektit nuk arriti të bindë Komisionin dhe të përmbysë barrën e provës.

27. Automjet tip “Smart Coupe” me targë ***, regjistruar në emër të vajzës XH.B, blerë në datën 26.11.2014, me nr. *** rep., me certifikatë doganore *** Elbasan, ***, datë 27.11.2014. Vlera: 100,000 lekë. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit (vajza e subjektit, XH, ka deklaruar edhe: *Pjesa që zotëron vajza 100%*).

Hetimi i kryer dhe analiza e burimit të krijimit

27.1 Në DIPP-në e vitit 2014, XH.B ka deklaruar: *“Blerë makinë tip “Smart”, viti prodhimi 2004, ngjyrë e zezë, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** kol., datë 26.11.2014, për vajzën XH.B. Vlera: 100,000 lekë. Zhdoganimi i bërë nga shoqëria “***”, e përfunduar me autorizim nga L.B.XH sipas certifikatës doganore datë 27.11.2014, me vlerë takse 24,177 lekë”.*

27.2 Nga dokumentacioni i administruar⁵⁹ gjatë hetimit rezultoi se sipas certifikatës së pronësisë datë 6.3.2020, XH.B është pronare e automjetit tip “Smart” me targë ***, vit prodhimi 2004, të

⁵⁹ Kontratë shitblerjeje automjeti nr.*** rep., nr. *** kol., datë 26.11.2014, që subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dhe dosja e dërguar nga DPSHTRR-ja me shkresat nr. *** prot., datë 9.8.2017 dhe nr. *** prot., datë 10.10.2017, e DPSHTRR-së (dosja *Vetting*), si dhe shkresa nr. *** prot., datë 23.4.2024, në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 11.4.2024, të Komisionit.

cilin e ka blerë me kontratë shitblerjeje datë 26.11.2014 nga pronari, shoqëria “**** ” ***, në vlerën 100,000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.6.2020, XH.B ia ka shitur këtë automjet blerësit A.Q, me vlerë 140,000 lekë.

27.3 Në deklaratën *Vetting* është deklaruar si burim krijimi “Të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortit”. Nga analiza financiare për periudhën 1.1.2014 – 26.11.2014, rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të blerë automjetin tip “Smart Coupe” me vlerë 100,000 lekë, në datën 26.11.2014, për shkak të balancës negative të analizës financiare prej -174,836 lekësh⁶⁰.

27.4 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, se duket që subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Smart Coupe”, pasi në datën e blerjes, 26.11.2014, rezultoi me balancë negative në vlerën -174,836 lekë.

27.5 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti shpjegime në lidhje me barrën e provës, prandaj Komisioni i qëndron konstatimit të mësipërm.

28. Depozitë bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank, dega Elbasan, në emër të vajzës XH.B, krijuar në datën 30.12.2003. Vlera: 359,809.61 lekë. Burimi i krijimit: Vazhdim i llogarisë *futura*, hapur nga subjekti dhe bashkëshorti, nga kursimet prej pagave (deklaruar edhe nga vajza XH: *Pjesa që zotëron vajza është 100%*)⁶¹.

Deklarimet në deklaratat periodike

28.1 Në DIPP-në e vitit 2003: “*Depozitë futura ABA. Vlera 0.15 milion në Bankën Amerikane. Burimi i krijimit: nga pagat dhe depozitë futura ABA në emër të fëmijëve. Vlera 0.1 milion në Bankën Amerikane. Burimi i krijimit: nga pagat*”.

28.2 Në DIPP-në e vitit 2011: “*Depozitë bankare tek Intesa Sanpaolo e vajzës XH.B, në vlerën 1,307,040 lekë*”.

⁶⁰ Pasuritë 155,953 lekë (shitesha /pakësime likuiditeteve 255,953 lekë - automjet “Smart Coupe” me targë ***, datë 26.11.2014, vlera 100,000 lekë); gjendja likuiditeteve 5,293,926 (likuiditete në banka 3,163,886 lekë + *cash*, deklaruar në DPV 2,130,040 lekë); detyrime 320,942 lekë; pasuri neto (pasuri - detyrime) 164,989 lekë; të ardhurat 1,684,942 (të ardhurat nga paga e subjektit 1,345,331 lekë + të ardhurat nga paga e bashkëshortit 214,896 lekë + të ardhurat nga interesat bankarë 124,715 lekë); shpenzimet 1,694,788 lekë (shpenzime jetike 806,659 lekë - zbritur shpenzimet jetike për bashkëshortin UP 72,328 + shpenzime TIMS 517,817 + shpenzime shkollimi XH, periudha 2010 – 2015 Universiteti P 280,140 lekë + shpenzime qiraje XH, periudha 10.10.2011 – 8.2015, vlera 162,500 lekë). Mundësia për kursime -174,836 lekë.

⁶¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*: (i) vërtetim datë 25.1.2017 nga Intesa Sanpaolo Bank, që konfirmon se XH.B ka llogari bankare në vlerën 359,809 lekë, në datën 25.1.2017. Kjo llogari është vazhdimi i llogarisë *futura*, e çelur në datën 30.12.2003 nga prindërit Rajmonda dhe P.B; (ii) pozicionin i përgjithshëm i klientit XH.B nga Intesa Sanpaolo Bank; llogari kursimi në vlerën 1.064 lekë dhe llogari rrjedhëse në vlerën 358.745 lekë, në datën 25.1.2017; (iii) nxjerrje llogarie bankare datë 25.1.2017 nga Intesa Sanpaolo Bank, nga ku rezultoi se në datën 9.7.2010 në llogarinë në emër të XH.B është kredituar shuma 1,256,133 lekë dhe në datën 21.12.2010 është çelur depozitë në vlerën 1,200,000 lekë; (iv) nxjerrje llogarie bankare datë 25.1.2017 nga Intesa Sanpaolo Bank, në emër të XH.B, për periudhën 1.1.2003 – 25.1.2017, ku figuron se nga shtetasi P.B është depozituar në datën 4.4.2007 shuma 500,000 lekë dhe në datën 10.12.2007 shuma 400,000 lekë.

28.3 Në DIPP-në e viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015 janë deklaruar interesat vjetorë të depozitës ekzistuese të vajzës XH.B pranë Intesa Sanpaolo Bank, në vlerat përkatëse: 88,774.76 lekë; 47,661.55 lekë; 12,588.40 lekë; 8,460.80 lekë.

28.4 Në DIPP-në e vitit 2016, XH.B ka deklaruar: “*Depozitë bankare në Intesa Sanpaolo Bank. Burim i kësaj llogarie, e hapur nga kursimet nga pagat e prindërve në vitin 2003. Vlera: 359,809.61 euro. Pjesa që zotëron 100%*”.

28.5 Intesa Sanpaolo Bank nëpërmjet disa vërtetimeve⁶² konfirmon se në emër të XH.B: për periudhën 1.1.2012 – 31.12.2012, shuma e interesit bruto është 48,074.72 lekë; për periudhën 1.1.2014 – 31.12.2014, shuma e interesit bruto është 12,588.40 lekë; në datën 20.10.2016, llogaria në emër të XH.B ka gjendje 380,888 lekë.

28.6 Sipas të dhënave nga Intesa Sanpaolo Bank⁶³, XH.B ka llogari rrjedhëse në vlerat 344,765 lekë dhe 1,064 lekë, në datën 30.1.2017. Gjithashtu⁶⁴, për periudhën 30.12.2003 – 14.7.2010 XH.B ka pasur një llogari, në të cilën veprimet janë kryer nga babai i saj, P.B. Kjo llogari bankare është çelur në datën 30.12.2003 nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 150,000 lekë dhe është shtuar në vitin 2007 me dy depozitime *cash*, konkretisht 500,000 lekë dhe 400,000 lekë në datat 4.4.2007 dhe 10.12.2007, si dhe shtuar ndër vite me interesat e akumuluar. Më pas, në vitin 2010, me arritjen e moshës madhore, kjo llogari është mbyllur dhe XH.B ka hapur një llogari personale në Intesa Sanpaolo Bank, me gjendje 358,745.57 lekë, në datën 25.1.2017.

28.7 Në lidhje me ligjshmërinë e burimeve të krijimit, Komisioni konstatoi se në datën 30.12.2003, kur bashkëshorti i subjektit ka depozituar 150,000 lekë për vajzën XH.B dhe 100,000 lekë për vajzën H.B, analiza financiare e subjektit ka rezultuar me një balancë negative, në vlerën -110,886 lekë.

28.8 Nga tërësia e veprimeve bankare rezultoi se për vitin 2007, bashkëshorti i subjektit ka shtuar depozitat me 1,000,000 lekë në datën 4.4.2007 (nga 500,000 lekë në depozitën e secilës vajzë), 1,000,000 lekë dhe 5,000 euro në datën 10.12.2007 (nga 400,000 lekë në depozitën e secilës vajzë + 200,000 lekë dhe 5,000 euro në depozitat që ai ka bashkë me subjektin), duke rritur likuiditetet bankare në total për vitin 2007 me 3,078,352 lekë.

28.9 Gjatë hetimit⁶⁵, subjektit ka dhënë shpjegime në lidhje me burimet e krijimit të këtyre depozitave të shtuara në vitin 2007, duke deklaruar se burimi i të ardhurave në shtimin e depozitave të vajzave me nga 500,000 lekë dhe 400,000 lekë dhe depozitimin e shumave 200,000 lekë dhe 5,000 euro në llogarinë e përbashkët, kanë ardhur nga puna e bashkëshortit të saj si shofer prej disa vitesh në transport ndërkombëtar. Gjithashtu, ai ka siguruar të ardhura edhe nga pagesat që ka marrë nga emigrantët shqiptarë jashtë shtetit për shërbimet që u mundësonte, duke u sjellë nga shteti grek për familjarët e tyre në Shqipëri dhe anasjelltas mallra apo dokumentacion, veprim ky që njihet gjerësisht se kryhet nga të gjithë shoferët e linjave ndërkombëtare.

⁶² Me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021, të ILDKPKI-së, dërguar Komisionit (vërtetimet datë 18.3.2013, datë 5.3.2015 dhe datë 20.10.2016).

⁶³ Shkresa nr. *** prot., datë 21.7.2017 (aneks nr. 9 në dosjen *Vetting*).

⁶⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 16.3.2021, e ISP Bank.

⁶⁵ Përgjigjja nr. 1 e pyetësorit nr. 3.

28.10 Shumat në emër të vajzave si depozitë bankare (*futura*) në këtë vit u vendosën sepse Intesa Sanpaolo Bank ofronte një depozitë të favorshme për fëmijë, me përqindje të lartë interesi, të quajtur *futura*. Ndërsa shumat e depozituara në llogarinë e përbashkët midis subjektit dhe bashkëshortit janë kursime nga të ardhurat nga puna e tyre, të cilat në atë moment kanë vlerësuar për t'i depozituar në bankë.

28.11 Subjekti ka depozituar bashkëlidhur këtyre shpjegimeve dokumentacionin⁶⁶ për të provuar të ardhurat e bashkëshortit në periudhën 1993 – 2003 pranë shoqërive “****” dhe “****”, me vlerë totale 25,000 USD dhe 54,000 marka gjermane.

28.12 Nga analiza financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të shtuar me burime të ligjshme depozitën e vajzës, rezultoi se ata kanë pasur mundësi që me të ardhura të ligjshme të shtojnë depozitën në datën 4.4.2007 me 500,000 lekë, pasi analiza ka rezultuar me balancë pozitive⁶⁷, ndërsa në datën 10.12.2007 nuk kanë pasur mundësi të krijojnë shtesën prej 400,000 lekësh me burime të ligjshme, për shkak të balancës negative të analizës financiare⁶⁸.

28.13 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit se duket që subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e depozitës së vajzës në vitin 2003 për shkak të balancës negative të këtij viti, si dhe për shtesën prej 400,000 lekësh në datën 10.12.2007, për shkak të balancës negative për periudhën 5.4.2007 – 31.12.2007.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

28.14 Subjekti i rivlerësimit për të kundërshtuar rezultatin e hetimit ka shpjeguar se sipas saj balancat negative për vitet 2003 dhe 2007 nuk ekzistojnë, nëse Komisioni nuk do të bënte analizë financiare fragmentare dhe nëse do të përfshinte në të të ardhurat nga puna dhe dietat vjetore të bashkëshortit.

Vlerësimi i Komisionit

⁶⁶ (i) Kërkesë datë 16.11.2021 e subjektit drejtuar shoqërisë “****” për kërkimin e dokumentacionit të pagesave që bashkëshorti ka përfituar gjatë detyrës në këtë shoqëri; (ii) vërtetim nga shoqëria “****”, që konfirmon se shtetasi P.B ka punuar pranë kësaj shoqërie me detyrë shofer kamioni në transportin ndërkombëtar nga data 5.10.1993 deri më 13.11.1995 dhe gjatë kësaj periudhe është paguar sipas rrugëve që kryente, me pagë totale 25,000 USD, por shoqëria nuk disponon asnjë dokument për pagat si pasojë e trazirave të vitit 1997, kur u dogj i gjithë dokumentacioni i shoqërisë; (iii) vërtetim nga shtetasi E.B (nuk shënohet se me çfarë cilësie ky person ka lëshuar këtë vërtetim), që konfirmon se shtetasi P.B ka punuar pranë shoqërisë së transportit “****” si shofer kamioni në transportin ndërkombëtar nga data 1.3.1996 deri më 17.2.2003 dhe ka përfituar pagat në total 54,000 marka gjermane, koha aktive 4-5 muaj/vit, e paguar me 2,000 marka gjermane plus dieta me transfertë.

⁶⁷ Periudha 1.1.2007 – 4.4.2007: pasuritë 212,524 lekë (shitesa/pakësime të likuiditeteve); gjendja e likuiditeteve 5,089,021 lekë (likuiditete në banka 4,689,021 lekë + *cash*, deklaruar në DPV 400,000 lekë); të ardhurat 278,766 lekë (të ardhurat nga paga subjektit 222,334 lekë + të ardhurat nga paga e bashkëshortit 41,392 lekë + të ardhura nga interesat bankarë 15,040 lekë); shpenzimet 134,000 (shpenzime jetike 136,620 lekë - shpenzimet jetike për bashkëshortin UP 2,620.11 lekë); mundësia për kursime 357,289 lekë.

⁶⁸ Periudha 5.4.2007 – 31.12.2007: pasuritë 7,874,556 lekë (apartament banimi 83 m², Vlorë 5,803,680 lekë + shtesa/pakësime të likuiditeteve 2,070,876); gjendja e likuiditeteve 7,159,897 lekë (likuiditete në banka 6,759,897 lekë + *cash*, deklaruar në DPV 400,000 lekë); detyrime 5,760,709 lekë (kredia në Alpha Bank 48,000 euro, datë 28.12.2007 vlera 5,803,680 lekë + pagesë kësti 42,971 lekë); pasuri neto (pasuri - detyrime) 2,113,847 lekë; të ardhurat 791,177 lekë (të ardhurat nga paga e subjektit 667,002 lekë + të ardhurat nga paga e bashkëshortit 124,175); shpenzimet 2,544,432 lekë (shpenzime jetike 409,860 lekë - shpenzimet jetike për bashkëshortin UP 13,849 lekë + shpenzime TIMS 188,861 lekë + shpenzime për pagesë apartamenti sipas kontratës së kaparit 1,934,560 lekë + shpenzime shkollimi H AL, periudha 2003 – 2012, vlera 25,000); mundësia për kursime -3,867,103 lekë.

28.15 Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit në prapësime nuk ka paraqitur asnjë provë të re në lidhje me të ardhurat. Gjithashtu, shpjegimet e subjektit në lidhje me shkaqet e balancave negative në analizën financiare nuk qëndrojnë pasi, ashtu sikundër është argumentuar edhe në pikën 23.56 e vijues të vendimit, fragmentimi i analizës financiare është kryer: (i) për shkak se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar në vitin pasardhës përdorimin e likuiditeteve si burim dhe, për këtë arsye, në analizë janë marrë të ardhurat e krijuara nga 1 janari deri në momentin e krijimit të pasurisë, pa përfshirë të ardhurat ndër vite; (ii) për shkak të balancave negative të rezultuara në momente të caktuara të krijimit të pasurive/likuiditeteve.

28.16 Në lidhje me pretendimin e subjektit për të përfshirë në analizë financiare të ardhurat nga puna e bashkëshortit dhe dietat vjetore që ai përfitonte, Komisioni, sikurse ka analizuar dhe vlerësuar në pikën 38 të këtij vendimi, nuk i ka njohur si të ligjshme të ardhurat nga dieta e bashkëshortit.

28.17 Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës.

29. Gjendje në llogarinë e pagës pranë Credins Bank, Elbasan, në datën 28.1.2017. Vlera: 798,375.52 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga paga si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Llogari rrjedhëse (overdraft) pranë Credins Bank, Elbasan. Karta “Visa Classic”. Gjendja në datën 28.1.2017, në vlerën 200,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

29.1 Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit dhe atij të administruar nga Komisioni për llogarinë bankare të pagës⁶⁹ dhe llogarinë rrjedhëse⁷⁰ në Credins Bank, nuk u konstatuan problematika për këto dy llogari bankare.

30. Depozitë bankare pranë bankës “S. H”, Gjermani. IBAN *, në emër të vajzës H.B, për efekte studimi. Vlera: 8,077.59 euro. Burimi i krijimit:** Llogaria *futura*, krijuar në datën 30.12.2003 pranë Intesa Sanpaolo Bank, Elbasan. Aktualisht llogaria është mbyllur në datën 29.3.2016 dhe është kaluar pranë bankës gjermane më lart. Llogaria ka ardhur si rrjedhim të kursimeve nga pagat e subjektit dhe bashkëshortit (vajza H ka deklaruar: *Pjesa që ajo zotëron është 100%*).

30.1 Referuar dokumenteve⁷¹ që subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, rezultoi se H.B ka studiuar pranë Qendrës Internacionale të Studimeve të Universitetit H në periudhën 18.10.2016 – 10.2.2017. Në emër të saj është hapur një llogari kursimi *futura*, në datën 30.12.2003, pranë Intesa Sanpaolo Bank nga prindërit, Rajmonda e P.B. Në datën 4.4.2007 janë depozituar shumat 500,000 lekë + 400,000 lekë nga shtetasi P.B. Në datën 27.11.2014 është çelur depozitë në vlerën 1,582,181

⁶⁹ Nxjerrje llogarie bankare të pagës, datë 28.1.2017, nga Credins Bank, në emër të Rajmonda Berishës, për periudhën 6.1.2016 – 28.1.2017 dhe shkresa nr. *** prot., datë 23.3.2021, e Credins Bank.

⁷⁰ Vërtetim datë 24.1.2017 nga Credins Bank; nxjerrje llogarie bankare e kartës “Visa Classic”, datë 28.1.2017, nga Credins Bank, në emër të znj. Rajmonda Berisha.

⁷⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 23.3.2021, e Credins Bank.

⁷¹ Vërtetim datë 21.10.2016 nga Universiteti H; kopje dokumenti në gjuhën gjermane; karta e studentit në emër të H.B (në gjuhën gjermane); diplomë e maturës shtetërore datë 4.7.2015; vërtetim datë 25.1.2017 nga ISP Bank; nxjerrje llogarie bankare datë 25.1.2017 nga ISP Bank në emër të H.B, për periudhën 1.1.2003 – 25.1.2017; nxjerrje llogarie bankare datë 25.1.2017 nga ISP Bank, në monedhën euro, në emër të H.B, për periudhën 27.8.2015 – 25.1.2017.

lekë. Nga data 27.11.2014 deri më 29.3.2016, kur është mbyllur, kjo llogari është administruar nga vetë H.B si person i maturuar. Në datën 29.3.2016 është transferuar vlera 8,077 euro, me përshkrimin “Fonde për studime në Gjermani”.

30.2 Referuar deklarimeve në deklaratat periodike, subjekti ka deklaruar për vitet 2011 – 2015 gjendjen e kësaj llogarie dhe interesat bankarë të përfutur prej saj. Në DIPP-në e vitit 2016, H.B ka deklaruar: “*Depozitë bankare e transferuar nga Intesa Sanpaolo Bank në datën 29.3.2016 në “S Bank” H – Gjermani, IBAN ***, shpenzime për shkollimin e vajzës në Gjermani. Burimi i kësaj llogarie, e hapur nga kursimet nga pagat e prindërve në vitin 2003. Vlera: 8,077.59 euro. Pjesa që zotëron 100%*”.

30.3 Sipas dokumenteve që ILDKPKI-ja ka përcjellë⁷² pranë Komisionit, ka rezultuar se H.B është regjistruar si studente në Universitetin H për semestrin e verës të vitit 2018, dega Gjuhë Kompjuterike, *bachelor*, për periudhën 1.4.2018 – 30.9.2018. Subjekti ka marrë përsipër të ndihmojë vajzën e saj H.B me shumën 720 euro/muaj për të ndjekur studimet në Gjermani, duke e kaluar këtë shumë në llogarinë e vajzës në bankën “S H”, Gjermani.

Analiza financiare e mundësisë së krijimit të kësaj pasurie

30.4 Referuar të dhënave nga Intesa Sanpaolo Bank⁷³, ka rezultuar se për periudhën 30.12.2003 – 27.11.2014 H.B ka pasur një llogari në të cilën veprimet janë kryer nga babai i saj, P.B. Kjo llogari bankare është çelur në datën 30.12.2003 nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 100,000 lekë dhe është shtuar në vitin 2007 me dy depozitime *cash*, konkretisht shumën 500,000 lekë në datën 4.4.2007 dhe shumën 400,000 lekë në datën 10.12.2007, si dhe shtuar ndër vite me interesat e akumuluar. Në nëntor të vitit 2014, me arritjen e moshës madhore, H.B ka transferuar shumën 1,582,181 lekë, duke hapur një llogari personale në lekë Intesa Sanpaolo Bank. Kjo llogari është pakësuar me konvertimin dhe transferimin e shumës 1,129,620 lekë në datën 15.7.2015, në llogarinë në euro me nr. ***, të hapur në këtë datë dhe mbyllur përfundimisht në datën 29.3.2016, ku pjesa e mbetur prej 463,130 lekësh ka kaluar përsëri në llogarinë në euro.

30.5 Kjo llogari bankare në monedhën euro ka shërbyer si një llogari furnizuese për llogarinë bankare në euro me nr. ***, me emërtimin “H. P. B G student”, llogari nga e cila janë kryer pagesa gjatë qëndrimit të saj për studime në Gjermani.

30.6 Llogaria bankare “H. P. B G student” në monedhën euro është hapur në datën 27.8.2015 dhe është mbyllur më 29.3.2016, duke transferuar shumën 8,077.59 euro në një llogari bankare në Gjermani në emër të vajzës së subjektit të rivlerësimit.

30.7 Në pyetësonin nr. 2, subjektit i është kërkuar të depozitojë pranë Komisionit nxjerrje të llogarive bankare të vajzës në Gjermani me IBAN *** dhe ***, që nga momenti i hapjes së tyre deri në datën 31.12.2016.

⁷² Me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021, të ILDKPKI-së (deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.3.2018, e subjektit të rivlerësimit; vërtetim datë 6.2.2018 nga Universiteti H).

⁷³ Shkresa nr. *** prot., datë 16.3.2021, e ISP Bank.

30.8 Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit llogarinë bankare me IBAN *** pranë bankës “S. H”. Për sa i përket llogarisë me IBAN ***, subjekti shpjegoi se nuk ka informacione, pasi është llogari që nuk ka qenë ndonjëherë në përdorim nga vajza e saj.

30.9 Nga veprimet bankare rezultoi se në datën 31.3.2016 Intesa Sanpaolo Bank ka kredituar në llogarinë me IBAN *** shumën 8,077.59 euro dhe në po këtë datë llogaria është pakësuar me 8,040 euro. H.B e ka përdorur këtë llogari për shpenzime të ndryshme si: pagesë qiraje, blerje biletash udhëtimi, si dhe shpenzime të tjera për jetesë gjatë qëndrimit të saj në Gjermani. Në këtë llogari janë kryer depozitime *cash*, si dhe rezultuan shuma monetare që kanë hyrë nëpërmjet transfertave.

30.10 Nga të gjitha veprimet bankare të kryera midis llogarive të vajzës së subjektit në Intesa Sanpaolo Bank (ku llogaria nr. *** është llogaria që ka shërbyer si burim për krijimin e shumës së depozituar në bankën “S. H”) rezultoi se burim i këtyre llogarive në euro është shuma 1,582,181 lekë, e gjeneruar nga depozita futura, krijuar që në datën 30.12.2003.

30.11 Në lidhje me ligjshmërinë e burimeve të krijimit të depozitës *futura*, Komisioni konstatoi se në datën 30.12.2003, kur bashkëshorti i subjektit ka depozituar 150,000 lekë për vajzën H.B dhe 100,000 lekë për vajzën H.B, analiza financiare e subjektit rezultoi me balancë negative në shumën -110,886 lekë.

30.12 Në lidhje me shtesat e depozitës, ashtu sikurse konstatohet në pikën 28.12 të këtij vendimi, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë rezultuar me balancë negative për shtesën 400,000 lekë, në datën 10.12.2007.

30.13 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e depozitës *futura* të vajzës në vitin 2003, për shkak të balancës negative të këtij viti, si dhe për shtesën prej 400,000 lekësh në datën 10.12.2007, për shkak të balancës negative për periudhën 5.4.2007 – 31.12.2007 (kjo barrë prove është kaluar edhe tek depozita *futura* e vajzës XH.B).

30.14 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit është trajtuar në pikat 28.14-28.15 të këtij vendimi.

30.15 Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës.

31. Llogari bankare pranë Raiffeisen Bank, Elbasan, datë 10.12.2010, me nr. klienti *, shumë e cila aktualisht ka kaluar në fondin Invest Prestige pranë kësaj banke. Vlera: 460,000 lekë.**

Analiza financiare e mundësisë së krijimit të kësaj pasurie

31.1 Sipas të dhënave nga Raiffeisen Bank, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka llogari rrjedhëse në vlerën -756 lekë, në datën 30.1.2017⁷⁴ dhe ka investuar në fondin Raiffeisen Prestige vlerën 520.872 lekë, në datën 30.1.2017⁷⁵, ndërsa në datën 23.2.2021 vlera e këtij fondi është në

⁷⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2017 (aneks nr. 7 në dosjen *Vetting*).

⁷⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2017 (aneks nr. 25 në dosjen *Vetting*).

shumën 579,625.70 lekë⁷⁶. Subjekti i rivlerësimit ka investuar shumën 600,000 lekë, në datën 3.5.2012 dhe gjatë vitit 2013 ka tërhequr nga fondi vlerën 241,206 lekë.

31.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim krijimi për fondin e investimit shumën 460,000 lekë, të krijuar në llogari në datën 10.12.2010, me burim “Pagat e akumuluar të subjektit”.

31.3 Nga veprimet bankare rezultoi se në datën 10.12.2010, me gjendjen e akumuluar nga pagat, subjekti ka çelur depozitë 1-vjeçare në vlerën 460,000 lekë, e cila ka vazhduar deri në dhjetor 2013 (edhe pas krijimit të fondit 3.5.2012) dhe më pas e ka shpenzuar atë gradualisht nëpërmjet tërheqjeve *cash* ose blerjeve të ndryshme.

31.4 Sipas nxjerrjes së llogarisë në Raiffeisen Bank⁷⁷, vihet re se shuma 600,000 lekë, që ka shërbyer për blerjen e kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestige, është depozituar *cash* nga subjekti në datën 3.5.2012.

31.5 Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të fondit të investimit Raiffeisen Prestige në Raiffeisen Invest “Likuiditetet e mbartura dhe deklaruara më parë në shtëpi”, pra gjendjen *cash*.

31.6 Nga leximi i deklaratave periodike për gjendjen *cash*, Komisioni konstaton se për vitin 2011 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vlerat 1,500,000 lekë dhe 16,000 euro, ndërsa për vitin 2012 ka deklaruar gjendje *cash* në vlerat 700,000 lekë dhe 8,000 euro. Pra, duket se subjekti ka pasur gjendje *cash* për krijimin e fondit të investimit, por balancat negative që kanë rezultuar nga analiza financiare për periudhën 2003 – 2011 cenojnë ligjshmërinë e kursimeve *cash* të deklaruara si burim krijimi për këtë investim.

31.7 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit se subjekti nuk ka deklaruar saktë në deklaratën *Vetting* burimin e krijimit të fondit të investimit në Raiffeisen Prestige, pasi si burim nuk ka shërbyer depozita 460,000 lekë e krijuar nga pagat në datën 10.12.2010, por likuiditetet e mbartura dhe deklaruara më parë në shtëpi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

31.8 Subjekti në prapësime ka shpjeguar se ka deklaruar në deklaratën *Vetting* që gjendja e llogarisë në emër të saj nga Raiffeisen Invest në datën 26.1.2017 është 520,672 lekë. Në datën 3.5.2012 ka investuar vlerën 600,000 lekë. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2012 ka deklaruar: “*Depozitë në formë investimi në fondin e investimit tek Raiffeisen Bank, vlerë e cila rrjedh nga likuiditetet e mbartura dhe të deklaruara më parë në shtëpi. Vlera: 600,000 lekë*”. Në deklaratën *Vetting* mund të ketë pasur pasaktësi në mënyrën se si është deklaruar, por që nuk ka pasur ndryshim deklarimi në lidhje me burimin e të ardhurave për krijimin e fondit të investimit në Raiffeisen Prestige. Dokumentet⁷⁸ bashkëlidhur këtyre shpjegimeve provojnë se deklarimi është i vërtetë.

⁷⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 26.2.2021, e Raiffeisen Invest dhe “Nxjerrja e llogarisë” bashkëlidhur shkresës.

⁷⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 11.2.2021.

⁷⁸ Vërtetim datë 15.1.2021, lëshuar nga Raiffeisen Bank, si dhe 4 fletë të lëshuara nga Raiffeisen Bank në datat 18.1.2021, 5.5.2020 dhe 24.4.2019, nga përmbajtja e të cilave provohet që subjekti ka vendosur depozitën në Raiffeisen Invest.

Vlerësimi i Komisionit

31.9 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime kontradiktore, pasi nga njëra anë shpjegon se në deklaratën *Vetting* mund të ketë pasur pasaktësi në mënyrën se si është deklaruar, por nga ana tjetër pretendon se burimi i krijimit të fondit të investimit mbetet i njëjtë.

31.10 Komisioni, nga ana e tij, gjatë hetimit konstatoi pasaktësi pikërisht në burimin e krijimit, i cili rezultoi të jetë “Likuiditetet e mbartura dhe të deklaruara më parë në shtëpi”, sikurse deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2012, dhe jo burimi i deklaruar në deklaratën *Vetting* “Paga si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

31.11 Për sa më lart, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës.

32. Të ardhurat nga paga si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për periudhën 16.8.1987 – 31.12.2016. Vlera: 18,854,877 lekë, të deklaruara.

32.1 Referuar dokumentacionit që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës⁷⁹ dhe të dhënave nga ISSH-ja⁸⁰, Komisioni arrin në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga Komisioni.

Të ardhurat e deklaruara nga z. P.B, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit

33. Të ardhurat nga puna si shofer pranë *, qyteti Bajram Curri, rrethi Tropojë, për periudhën 1.7.1980 – 15.6.1990. Vlera: 816,000 lekë. Sipas ligjit të unifikimit të pagave, pas një përlogaritjeje të përafërt për këtë periudhë, paga rezulton 816,000 lekë, e faktuar kjo me vërtetimin nr. *** prot., datë 24.1.2017, lëshuar nga Dega e Sigurimeve Shoqërore Tropojë.**

Të ardhurat nga puna si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave në Parkun e Eksportit D, për periudhën 9.7.1990 – 16.9.1993, bazuar në librezën e punës me nr.rregjistri themeltar *. Për arsye të mosdisponimit të dokumentit përkatës nga kjo ndërmarrje, si pasojë e mosekzistencës së saj, paga për periudhën e lartpërmendur rezulton 273,600 lekë.**

33.1 Referuar dokumentacionit që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*⁸¹ dhe të dhënave nga ISSH-ja⁸², rezultoi se dy deklaratimet e subjektit si më lart përputhen me

⁷⁹ (i) Vërtetimi nr. ***, datë 18.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për pagat nga data 1.1.1995 deri më 31.12.2016; (ii) Sipas vërtetimit nr. ***, datë 10.1.2017, nga kjo Prokurori, për pagat nga data 16.8.1987 deri më 31.12.1994 nuk mund të vihen në dispozicion të dhëna, pasi nuk disponohen dokumente të listëpagesave të punonjësve të trashëguara nga ish-Prokuroria Elbasan.

⁸⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 24.7.2017, e ISSH-së (dosja *Vetting*) dhe shkresa nr. *** prot., datë 2.3.2021, e ISSH-së.

⁸¹ Librezë pune nr. *** e shtetasit P.B, ku rezulton se ky shtetas ka punuar si shofer pranë ***, qyteti Bajram Curri, rrethi Tropojë, periudha 1.7.1980 – 15.6.1990; librezë pune nr. ***, që provon deklarimin e subjektit që provon pabesimin e shtetasit P.B si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave në Parkun e Eksportit D, në periudhën 9.7.1990 – 16.9.1993.

⁸² Shkresa nr. *** prot., datë 12.4.2024, e ISSH-së, Drejtoria e Arkivit Qendror, që konfirmon punësimin e shtetasit P.B si shofer pranë ***, qyteti Bajram Curri, rrethi Tropojë për periudhën 1.7.1980 – 15.6.1990, si dhe punësimin si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave në Parkun e Eksportit D, periudha 9.7.1990 – 16.9.1992.

dokumentacionin e administruar nga Komisioni për sa i përket periudhave të punësimit të bashkëshortit të saj, por jo për sa i përket të ardhurave të deklaruara.

33.2 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit që nuk vërtetohet vlera e të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit si shofer pranë ***, qyteti Bajram Curri, rrethi Tropojë dhe në Parkun e Eksportit D.

33.3 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur shpjegime dhe prova të tjera në prapësime, prandaj Komisioni arrin në përfundimin se subjekti nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës.

34. Të ardhurat nga puna si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave pranë shoqërisë “**”, Kavajë, për periudhën 5.10.1993 – 13.11.1995. Vlera: 25,000 USD.** Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Duke qenë se periudhat e sipërpërmendura përkojnë me periudhën e tranzicionit, kam punuar në të zezë duke u paguar në varësi të rrugës me mandat dore. Një pjesë e këtyre mandateve është dorëzuar në deklaratimet e bëra më parë në zyrat e ILDKPKI-së”.*

Të ardhurat nga puna si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave pranë shoqërisë “**”, Tiranë, për periudhën 1.3.1996 – 17.2.2003. Vlera: 54,000 DM.** Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Duke qenë që periudhat e sipërpërmendura përkojnë me periudhën e tranzicionit, kam punuar në të zezë duke u paguar në varësi të rrugës me mandat dore. Një pjesë e këtyre mandateve është dorëzuar në deklaratimet e bëra më parë në zyrat e ILDKPKI-së”.*

34.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* disa mandate arkëtimi në lidhje me shumat e përfituara nga shtetasi P.B prej shoqërisë “****”⁸³.

34.2 Referuar deklaratimit të subjektit që deklaroi se bashkëshorti i saj ka punuar në të zezë, Komisioni vlerëson që në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ardhurat e krijuara nga kjo punë nuk janë të ardhura të ligjshme, prandaj nuk i përfshiu në analizën financiare.

35. Të ardhurat nga puna si shofer autobusi në linjën Tiranë-Athinë-Tiranë, pranë shoqërisë “**”, Tiranë, për periudhën 1.3.2003 – 31.12.2007. Vlera: 647,637 lekë. Një pjesë e të ardhurave për këtë periudhë kohore vijnë nga dietat e deklaruara ndër vite, të cilat nuk i janë vënë në dispozicion aktualisht nga firma në fjalë. Vlera: 16,820 euro.**

35.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga paga dhe dietat në deklaratimet periodike për periudhën 2003 – 2007. Referuar dokumentacionit⁸⁴ që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, rezultoi se bashkëshorti i saj është punësuar pranë shoqërisë “****” sh.a. dhe

⁸³ Nr. 5, datë 20.1.2002, vlera 1,500 USD; nr. ***, datë 4.12.1998, vlera 2,900; nr. ***, datë 13.3.2001, vlera 2,000 DM; datë 1.11.2004, vlera 1,012 euro, paguar nga shtetasi A.A (shpenzime udhëtimi e dieta); nr.***, datë ***, vlera 1,186 euro; datë 30.11.2005, vlera 4,000 euro; datë 27.12.2004, vlera 816 euro (shpenzime udhëtimi e dieta); datë 4.4.2005, vlera 1,415 euro (shpenzime udhëtimi e dieta); nr.***, datë ***, vlera 6,700 lekë; datë 1.11.2005, vlera 3,722 euro (për tërheqjen e automjetit Ford); datë 26.1.2005, vlera 1,737 euro (shpenzime udhëtimi e dieta); datë 22.4.2005, vlera 1,500 lekë (shpenzime udhëtimi në Gjermani); datë 7.6.2005, vlera 1,439 euro (shpenzime udhëtimi e dieta); datë 11.8.2005, vlera 2,108 euro (shpenzime udhëtimi e dieta dhe servis); datë 22.4.2005, vlera 3,345 euro (shpenzime udhëtimi e dieta për auton e ri); datë 18.5.2006, vlera 120 euro (shpenzime e dieta); datë 7.8.2006, vlera 1,369 euro (shpenzime udhëtimi e dieta); datë 31.3.2006, vlera 465 euro; datë 2.5.2006, vlera 1,780 euro.

⁸⁴ Librezë pune nr. ***, librezë kontributësh për sigurimet shoqërore e shëndetësore nr. ***, vërtetim datë 4.3.2008 dhe vërtetim datë 27.1.2017 nga shoqëria “****”.

janë derdhur kontribute në periudhën korrik 2003 – dhjetor 2007, si dhe konfirmohen nga kjo shoqëri të ardhurat neto që bashkëshorti ka përfituar për periudhën 1.3.2003 – 31.12.2007, ku vetëm për vitin 2007 të ardhurat neto nga pagat kanë qenë në vlerën 175,872 lekë dhe dietat 2,820 euro.

35.2 Referuar vërtetimit datë 4.3.2008 nga shoqëria “****” dhe deklarimeve në DIPP-në e viteve 2005 – 2007, kuptohet se të ardhurat në lekë janë nga pagat dhe të ardhurat në euro nga dietat.

35.3 Subjekti ka deklaruar pranë ILDKPKI-së⁸⁵ se të ardhurat e deklaruara në vitin 2006 për udhëtim e dieta që i përkasin bashkëshortit janë të gjitha neto, pasi janë hequr shpenzimet.

35.4 Sipas ISSH-së⁸⁶, të ardhurat që bashkëshorti ka përfituar nga paga si i punësuar pranë shoqërisë “****”, Tiranë, gjatë periudhës korrik 2003 – dhjetor 2007, janë në shumën 523,289 lekë.

35.5 Komisioni i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare.

36. Të ardhurat nga puna si shofer autobusi në linjën Tiranë-Athinë-Tiranë, pranë shoqërisë “**”, Lushnjë, për periudhën 1.2.2008 – 28.2.2013. Vlera: 1,406,904 lekë. Një pjesë e të ardhurave për këtë periudhë kohore vijnë nga dietat. Vlera: 54,900 euro.**

36.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga paga dhe dietat në deklaratimet periodike për periudhën 2008 – 2013.

36.2 Referuar dokumentacionit⁸⁷ që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, rezultoi se bashkëshorti i saj është punësuar si shofer autobusi pranë shoqërisë “****”, Lushnjë, për periudhën 1.2.2008 – 28.2.2013 dhe janë derdhur kontribute në periudhat janar 2008 – shtator 2010 dhe janar 2011 – shkurt 2013, ndërsa kjo shoqëri ka konfirmuar të ardhurat neto nga paga që shtetasi P.B ka përfituar si i punësuar shofer për periudhën 1.2.2008 – 28.2.2013.

36.3 Komisioni ka administruar dokumentacionin⁸⁸, nga ku ka rezultuar se shtetasi P.B, i punësuar pranë shoqërisë “****” sh.p.k. gjatë periudhës dhjetor 2011 – shkurt 2013, ka përfituar të ardhura neto nga pagat, në shumën 1,406,904 lekë, për të cilat ka paguar edhe tatimin mbi të ardhurat personale dhe dieta në shumën 54,900 euro.

36.4 Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të ardhura nga pagat në shumën 1,406,904 lekë.

37. Të ardhurat nga puna si shofer autobusi në linjën ndërkombëtare turistike, në shoqërinë “**” sh.p.k., Tiranë, për periudhën kohore 4.4.2013 – 31.12.2016. Vlera: 746,104 lekë. Një pjesë e të ardhurave për këtë periudhë kohore vijnë nga dietat. Vlera: 36,600 euro.**

37.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike të ardhurat nga paga dhe dietat për periudhën 2013 – 2016.

⁸⁵ Deklaratë dore e subjektit e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021, të ILDKPKI-së.

⁸⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 15.4.2024, të ISSH-së.

⁸⁷ Librezë pune nr. ***, librezë kontributësh për sigurimet shoqërore e shëndetësore nr. ***, vërtetim nr. ***, datë 20.1.2017, nga shoqëria “****”, Lushnjë.

⁸⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 24.7.2017, e ISSH-së (dosja *Vetting*); shkresa nr. *** prot., datë 4.3.2021, nga DPT-ja. Me shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2021 dhe vërtetimin nr. ***, datë 15.4.2024, Drejtoria e Arkivit Qendror të ISSH-së konfirmon se kjo drejtori për shoqërinë “****” Lushnjë nuk disponon dokumentacion për periudhën shkurt 2008 – dhjetor 2012.

37.2 Referuar dokumentacionit⁸⁹ që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, rezultoi se shtetasi P.B, për periudhën kohore 4.4.2013 – 31.12.2016, ka qenë i punësuar shofer autobusi në linjën ndërkombëtare turistike, pranë shoqërisë “****” sh.p.k., Tiranë dhe janë derdhur kontribute për këtë periudhë, ndërsa kjo shoqëri ka konfirmuar pagat dhe dietat që ka përfituar ky shtetas.

37.3 Komisioni ka administruar dokumentacionin⁹⁰, nga kanë rezultuar pagat bruto, pagat neto dhe kontributet shoqërore-shëndetësore të paguara për shtetasin P.B nga punëdhënësi “****” sh.p.k., për periudhën prill 2013 – dhjetor 2016, si dhe përfshiu në analizën financiare të ardhura nga paga në shumën 876,244 lekë.

38. Të ardhurat nga puna si shofer në transportin ndërkombëtar të mallrave apo të udhëtarëve, të përfituara në formën e dietave, si vijon:

38.1 Referuar deklarimeve në vijim, Komisioni hetoi dhe analizoi më vete të ardhurat nga dietat gjatë punës së bashkëshortit si shofer transporti.

- *Të ardhurat nga puna si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave pranë firmës “****”, Kavajë, periudha 5.10.1993 – 13.11.1995. Duke qenë se periudhat e sipërpërmendura përkojnë me periudhën e tranzicionit, kam punuar në të zezë, duke u paguar në varësi të rrugës me mandat dore. Një pjesë e këtyre mandateve është dorëzuar në deklaratimet e bëra më parë në zyrat e ILDKPKI-së. Vlera 25,000 USD.*
- *Të ardhurat nga puna si shofer për transport ndërkombëtar të mallrave pranë firmës “****”, Tiranë, periudha 1.3.1996 – 17.2.2003. Duke qenë se periudhat e sipërpërmendura përkojnë me periudhën e tranzicionit, kam punuar në të zezë, duke u paguar në varësi të rrugës me mandat dore. Një pjesë e këtyre mandateve është dorëzuar në deklaratimet e bëra më parë në zyrat e ILDKPKI-së. Vlera 54,000 DM.*
- *Të ardhurat nga puna si shofer autobusi në linjën Tiranë-Athinë-Tiranë pranë firmës “****”, Tiranë, periudha 1.3.2003 – 31.12.2007. Vlera: 647,637 lekë. Një pjesë e të ardhurave për këtë periudhë kohore vijnë nga dietat e deklaruara ndër vite, por të cilat nuk më janë vënë në dispozicion aktualisht nga firma në fjalë. Vlera: 16,820 euro.*
- *Të ardhurat nga puna si shofer autobusi në linjën Tiranë-Athinë-Tiranë, pranë firmës “****”, Lushnjë, periudha 1.2.2008 – 28.2.2013. Vlera: 1,406,904 lekë. Një pjesë e të ardhurave për këtë periudhë kohore vijnë nga dietat. Vlera: 54,900 euro.*
- *Të ardhurat nga puna si shofer autobusi në linjën ndërkombëtare turistike, në shoqërinë “****” sh.p.k., Tiranë, periudha kohore 4.4.2013 – 31.12.2016. Vlera: 746,104 lekë. Një pjesë e të ardhurave për këtë periudhë kohore vijnë nga dietat. Vlera: 36,600 euro.*

⁸⁹ Librezë pune nr. ***, librezë kontributesh për sigurimet shoqërore e shëndetësore nr. ***, vërtetim nr. ***, datë 24.1.2017, nga shoqëria “****” sh.p.k.

⁹⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 4.3.2021, e DPT-së; shkresa nr. *** prot., datë 17.4.2024, e ISSH-së; shkresa nr. *** prot., datë 11.3.2021, e ILDKPKI-së, ku bashkëlidhen disa vërtetime nga shoqëria “****” sh.p.k., që konfirmon se shtetasi P.B, i punësuar shofer pranë saj, ka përfituar dieta për shërbimet, konkretisht: (i) vërtetimin datë 5.3.2015, ku për periudhën 1.1.2014 – 31.12.2014 dietat janë në vlerën 3,590 euro; dhe 3,000 lekë; (ii) vërtetimin datë 29.2.2016, ku për periudhën 1.1.2015 – 31.12.2015 dietat janë në vlerën 10,580 euro ose 1,481,200 lekë.

38.2 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* disa dokumente⁹¹, për të provuar se bashkëshorti i saj i punësuar shofer ka përfituar dieta nga këta punëdhënës: (i) shoqëria “****” gjatë vitit 2007 ka realizuar të ardhura neto nga dietat në vlerën 2,820 euro (si dhe të ardhura neto për vitet 2003 – 2007, por pa përcaktuar sa prej këtyre janë nga pagat dhe sa nga dietat); (ii) shoqëria “****”, Lushnjë, për periudhën 1.2.2008 – 28.2.2013, të ardhura nga dietat në vlerën 54,900 euro; (iii) shoqëria “****” sh.p.k. për periudhën 4.4.2013 – 31.12.2016, të ardhura nga dietat në vlerën 36,600 euro; (iv) për periudhën 1998 – 2006 të ardhura në vlerat 4,400 lekë, 1,500 USD, 2,000 DM dhe 24,569 euro.

38.3 Në DIPP-në e viteve 2003, 2005 – 2016 janë deklaruar të ardhurat nga pagat dhe nga dietat pranë punëdhënësve të ndryshëm. Të ardhurat nga dietat janë si vijon:

- Në DIPP-në e vitit 2003: *“Të ardhura të z. P.B në shumën 120,000 lekë nga agjencia “****” (shofer)”*.
- Në DIPP-në e vitit 2005: *“Shofer në firmën “****”, Tiranë (me linjën Tiranë-Athinë-Tiranë (bashkëshorti), në vlerën 120,000 lekë/vit dhe dieta për udhëtim (bashkëshorti), në vlerën 6,240 euro/vit mesatarisht”*.
- Në DIPP-në e vitit 2006: *“Bashkëshorti, shofer pranë firmës “****”, në vlerën 120,000 lekë/vit dhe bashkëshorti, dieta për udhëtim, në vlerën 7,800 euro”*.
- Në DIPP-në e vitit 2007: *“Shofer pranë firmës “****” (bashkëshorti), paga në vlerën 175,872 lekë dhe dieta për çdo udhëtim, për çdo rrugë 60 euro (bashkëshorti). Vlera: 7,820 euro”*.
- Në DIPP-në e vitit 2008: *“Paga e bashkëshortit 336,000 lekë. Dieta mesatare e bashkëshortit, 5,760 euro”*.
- Në DIPP-në e vitit 2009: *“Paga e bashkëshortit 336,000 lekë. Dieta e bashkëshortit 9,600 euro”*.
- Në DIPP-në e vitit 2010: *“Paga e bashkëshortit 336,000 lekë. Dieta e bashkëshortit 10,600 euro”*.

⁹¹ Vërtetim datë 4.3.2008 nga shoqëria “****”; vërtetim nr. ***, datë 20.1.2017 nga shoqëria “****” Lushnjë; vërtetim nr. ***, datë 24.1.2017, nga shoqëria “****” sh.p.k.; dokumentacion për pagesat nga dietat⁹¹ për periudhën 1998 – 2006 (mandatarkëtimi nr. ***, datë 4.12.1998, për shtetasin P.B, në vlerën 2.900; mandatpagesë nr. ***, datë 8.1.2002, nga shoqëria “****”, e cila paguan shtetasin P.B në vlerën 1,500 USD; mandatpagesë nr.**, datë 13.3.2001, nga shoqëria “****”, e cila paguan shtetasin P.B në vlerën 2,000 DM; mandatpagesë datë 1.11.2004, u pagua A.A në vlerën 1,012 euro, për shpenzime udhëtimi + dieta; mandatpagesë datë 31.1.2005, u pagua P.B në vlerën 4,000 euro; mandatpagesë, u pagua P.B në vlerën 1.186 euro; mandatpagesë datë 27.12.2004, u pagua P.B në vlerën 816 euro, për shpenzime udhëtimi + dieta; mandatpagesë datë 4.4.2005, u pagua P.B në vlerën 1,415 euro, për shpenzime udhëtimi + dieta; mandatpagesë datë 1.11.2005, u pagua P.B në vlerën 3.722 euro; mandatpagesë u pagua P.B në vlerën 6.700 lekë; mandatpagesë datë 26.1.2005, u pagua A.A në vlerën 1,737 euro, për shpenzime udhëtimi + dieta; mandatpagesë datë 22.4.2005, u pagua P.B në vlerën 1,500 lekë, me përshkrimin “Shpenzime udhëtimi Gjermani për auton e re”; mandatpagesë nr. ***, datë 11.8.2005, u pagua P.B në vlerën 2,108 euro, me përshkrimin “Shpenzime udhëtimi e dieta rr. *** – rr. *** dhe servis rr. ****”; mandatpagesë datë 7.6.2005, u pagua P.B (F.M) në vlerën 1.439 euro, me përshkrimin “Shpenzime udhëtime dhe dieta”; mandatpagesë datë 22.4.2005, u pagua P.B në vlerën 3,345 euro; mandatpagesë datë 18.5.2006, u pagua P.B në vlerën 120 euro, me përshkrimin “Shpenzime + dieta Mal i Zi”; mandatpagesë datë 7.8.2006, u pagua P.B në vlerën 1,369 euro, me përshkrimin “Shpenzime + udhëtime + dieta”; mandatpagesë datë 31.3.2006, u pagua P.B në vlerën 465 euro; mandatpagesë datë 2.5.2006, u paguar P.B në vlerën 1,780 euro).

- Në DIPP-në e vitit 2011: “Paga e bashkëshortit 336,000 lekë. Dieta e bashkëshortit 10,080 euro”.
- Në DIPP-në e vitit 2012: “Paga e bashkëshortit 336,000 lekë. Dieta e bashkëshortit 9,6000 euro”.
- Në DIPP-në e vitit 2013: “Paga e bashkëshortit 461,000 lekë. Dieta e bashkëshortit 6,060 euro”.
- Në DIPP-në e vitit 2014: “Paga e bashkëshortit 234,432 lekë. Dieta për punën e bërë (shërbime jashtë shtetit) e bashkëshortit 3,590 euro”.
- Në DIPP-në e vitit 2015: “Të ardhurat nga paga e bashkëshortit 234,432 lekë. Të ardhura nga dieta nga puna e bërë jashtë shtetit nga bashkëshorti 10,580 euro”.
- Në DIPP-në e vitit 2016: “Të ardhura nga paga e bashkëshortit si shofer pranë shoqërisë “***” sh.p.k., Tiranë, për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016. Vlera 234,432 lekë. Të ardhura nga dieta si shofer i bashkëshortit pranë shoqërisë “***” sh.p.k., Tiranë, periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016, bashkëlidhur vërtetimi. Vlera 1,200 euro”.

38.4 Referuar deklaratës *Vetting*, deklarimeve periodike, dokumentacionit të depozituar nga subjekti dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni⁹², vlera e dietave është përmbledhur si vijon:

Viti	Dieta të deklaruara në DIPP (euro)	Dieta të deklaruara në <i>Vetting</i> sipas vërtetimeve ⁹³ (euro)	Dieta të kaluara me bankë (euro)
2003			
2004			
2005	6,240		
2006	7,800		
2007	7,820		2,379
2008		9,900	
2009	9,600	10,800	
2010	10,600	10,800	
2011	10,080	10,800	
2012	9,600	10,800	
2013	6,060	7,500	
2014	3,590	8,320	
2015	10,580	10,580	
2016	12,000	12,000	

38.5 Subjekti, duke shpjeguar në pyetësonin standard punësimin e bashkëshortit si shofer pranë punëdhënësve të lartpërmendur, ka deklaruar se *çdo shpenzim gjatë periudhës së udhëtimeve në kuadër të punës si qëndrimi, ushqimi dhe kostot e udhëtimit janë hequr nga kompania përkatëse.*

⁹² Me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021, të ILDKPKI-së (vërtetim nr. *** prot., datë 20.1.2017, i shoqërisë “****”, për periudhën 1.2.2008 – 28.2.2013; vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga shoqëria “****”, për periudhën 4.4.2013 – 31.12.2016); shkresa nr. *** prot., datë 1.3.2021, e Tirana Bank.

⁹³ Vërtetim nr. *** prot., datë 20.1.2017, i shoqërisë “****”, për periudhën 1.2.2008 – 28.2.2013; vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, i shoqërisë “****”, për periudhën 4.4.2013 – 31.12.2016.

38.6 Sipas praktikës së Komisionit, vlerat e përfituara nga bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit në formën e dietave kanë destinacion mbulimin e shpenzimeve për nevoja ushqimore apo fjetje të kryera gjatë udhëtimeve të punës, prandaj në analizën financiare nuk u konsideruan në zërin “Të ardhura”, por u reduktuan shpenzimet e jetesës së tij për kohën e qëndrimit në udhëtime pune.

38.7 Për sa më lart, Komisioni vlerëson se në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të ardhurat e deklaruar me burim nga dietat nuk plotësojnë kriteret e këtij neni, prandaj nuk i përfshiu në analizën financiare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

38.8 Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatin e hetimit, në prapësimet e saj ka kërkuar që të përfshihen në analizë financiare të ardhurat e siguruara nga dietat e bashkëshortit dhe kështu do të rezultojë se subjekti ka pasur mundësi financiare për vënien e pasurisë dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare. Për këtë, subjekti ka paraqitur këto argumente:

- i) Subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar rregullisht në deklaratimet periodike të ardhurat e siguruara nga puna dhe dietat që përfitonte bashkëshorti si shofer në transportin ndërkombëtar. Deklarimet periodike, referuar praktikës së Komisionit dhe Kolegjit, përbëjnë provë për efekt të procesit të rivlerësimit.
- ii) Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka provuar se bashkëshorti i saj gjatë gjithë jetës së tij ka punuar si shofer në transportin ndërkombëtar të mallrave apo udhëtarëve.
- iii) Në analizën financiare që subjekti i ka bashkëlidhur prapësimeve, në të ardhurat e përfituara për çdo vit (2005 – 2019) nga dietat e bashkëshortit është përfshirë shuma e dietave që nuk është përdorur nga bashkëshorti për konsum ushqimor dhe që realisht i ka shërbyer familjes për shpenzime familjare (ushqim, argëtim, investim/blerje pasuri të luajtshme/të paluajtshme, etj.). Në pjesën më të madhe, bashkëshorti e ka mbuluar konsumin ushqimor për udhëtimet e punës brenda, e më shumë jashtë vendit, me të ardhurat familjare nga pagat, bakshishet dhe duke qëndruar tek të afërm që banonin në vendin ku ai ka kryer shërbimin.
- iv) Dietat e bashkëshortit duhet të konsiderohen si “të ardhura” edhe në kuptim të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili në nenin 4.i, në zërin “Të ardhura të tjera”, përfshin të ardhura që nuk identifikohen në format e tjera të paraqitura në këtë nen.
- v) Me deklaratat noteriale⁹⁴ të punëdhënësve që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur prapësimeve dhe me dokumentacionin që ka dorëzuar në ILDKPKI, provohet përtej çdo dyshimi se bashkëshorti ka punuar në transportin ndërkombëtar, ku trajtimi financiar për personat që ofrojnë këtë shërbim është i lartë për shkak të vështirësive që paraqet kjo natyrë

⁹⁴ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.6.2014, nga shtetasi E.B, i cili deklaron se shtetasi P.B ka punuar si shofer pranë shoqërisë së transportit “*****” në periudhën 1.3.1996 – 17.2.2003, kur ka përfituar totalisht 54,000 DM (2,000 DM/muaj + dieta në transfertë); deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.5.2024, nga shtetasi E.H, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “*****” sh.p.k., i cili deklaron se shtetasi P.B ka punuar si shofer pranë kësaj shoqërie në periudhën 5.10.1993 – 13.11.1995 dhe është paguar në varësi të rrugëve, duke përfituar pagën total në vlerën 25,000 USD, por deklaruesi nuk disponon asnjë dokumentacion për të ardhurat nga pagat, pasi në vitin 1997 është djegur i gjithë dokumentacioni ligjor e financiar.

pune, si dhe bashkëshorti i punësuar pranë këtyre punëdhënësve është paguar dhe është trajtuar me dieta në vlerat e deklaruara në deklaratimet periodike.

- vi) Të ardhurat e siguruara nga bashkëshorti janë depozituar rregullisht brenda sistemit bankar në mënyrë periodike, çka i bën ato të besueshme dhe të provueshme, duke shuar çdo dyshim për abuzim nga subjekti me burimin e të ardhurave.
- vii) Të ardhurat janë të fituara nga vetë bashkëshorti dhe nuk janë të dhuruara nga persona të tjerë, qoftë edhe me lidhje të afërt gjinore.
- viii) Ka vend për t'u aplikuar pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për pamundësinë objektive të subjektit që të paraqesë më shumë prova për të provuar të ardhurat e bashkëshortit nga puna, pavarësisht përprjekjeve të subjektit, për arsye:
- të vështirësive ekonomike dhe rrethanave që njihen gjatë periudhës pas vitit 1993, kur mekanizmat shtetërore nuk funksiononin dhe ishte e vështirë që të qëndroje në punë dhe të kërkoje nga punëdhënësi që të të regjistronte si punëmarrës;
 - kanë kaluar mbi 30 vjet dhe sipas legjislacionit për ruajtjen e dokumentacionit në ndërmarrjet shtetërore dhe ato private, dokumentacioni financiar nuk ruhet përtej këtij afati.
 - informaliteti i ekonomisë shqiptare në këto vite;
 - ballafaqimi me konceptin e taksimit mbi të ardhurat në një mënyrë të plotë vetëm pas miratimit të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998;
 - deklarata e integruar e të ardhurave personale e zbatuar vetëm pas vitit 2012;
 - licencimi i bankës së parë të nivelit të dytë në vitin 1999;
 - pagesat e pagave nëpërmjet sistemit bankar vetëm pas vitit 2002.
- ix) Këto rrethana dëshmojnë për deklaratim të saktë të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratimet periodike, mbi burimin e të ardhurave, prandaj Komisioni duhet ta vlerësojë deklaratimin si të besueshëm.
- x) ILDKPKI-ja i ka përfshirë në analizë financiare të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortit të subjektit dhe në raportin që ka dërguar për Komisionin nuk ka konkluduar problematika për pasurinë.
- xi) Konsiderimi i të ardhurave të bashkëshortit nga puna në transportin ndërkombëtar dhe dietat si një ndër burimet e përdorura për financimin e pasurive, është në harmoni me deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratimet periodike. Për këtë, edhe vetë Kolegji mban qëndrimin se sqarimi i deklarimeve të mëparshme në deklaratimet vijuese dhe në deklaratën *Vetting* duhet lexuar si korrigjim, për sa kohë objekt verifikimi janë deklaratimet periodike të interesave të deklaruara më parë në ILDKPKI, të cilat në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të shërbejnë si provë në këtë proces (referuar vendimit nr. 37/2021 të Kolegjit⁹⁵).

⁹⁵ Vendimi nr. 37/2021 i Kolegjit (pika 10.21): "...shpjegimet që subjekti ka dhënë në përgjigje të pyetjeve të pasqyruara në procesverbalin e datës 17.11.2011 dhe të shtruara nga inspektorja e lartë e ILDKPKI-së, R. R.. Kolegji vëren se ky akt është hartuar në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003, i cili parashikon se: Kur gjatë kontrollit zbulohet se deklaratimet nuk janë të sakta ose burimet e deklaruara nuk identifikohen dhe nuk mbulojnë pasuritë e deklaruara, Inspektorati i Lartë thërret subjektin për të dhënë shpjegime të hollësishme dhe argumentet përkatëse, të cilat paraqiten kurdoherë me shkrim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Në këto kushte, ky procesverbal i hartuar

Vlerësimi i komisionit

38.9 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se nuk u provua gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore që bashkëshorti i subjektit, gjatë udhëtimeve të punës brenda e jashtë vendit, e ka mbuluar konsumin ushqimor me të ardhurat nga bakshishet, pasi këto janë të ardhura të padeklaruara, të panjohura ligjërisht dhe, si të tilla, të pamatshme në vlerë. Duke pasur parasysh edhe numrin e lartë të udhëtimeve të punës ndër vite, subjekti nuk ka provuar numrin e udhëtimeve kur bashkëshorti i saj ka qëndruar tek të afërm që banonin në vendin ku ai ka kryer shërbimin. Si rrjedhojë, vlera e dietave që subjekti pretendon të jenë kursyer nga bashkëshorti i saj nuk është e matshme.

38.10 Komisioni vëren se afati i gjatë 30-vjeçar, për shkak të të cilit subjekti pretendon se nuk është ruajtur dokumentacioni i punësimit dhe pagesave pranë punëdhënësve, fillon në vitin 1994 e vijues kur bashkëshorti pretendohet se ka punuar pranë shoqërive “****” dhe “****” dhe për këtë punësim subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se ka qenë “në të zezë”, pra i paligjshëm. Si rrjedhojë, nuk mund të pretendohet për asgjësim/zhdukje të dokumentacionit në kushtet e një punësimi të paligjshëm, ku nuk mund të ketë fare dokumentacion të ligjshëm, të njohur dhe të kontrolluar nga institucionet përkatëse, përveç ndonjë dokumenti të brendshëm të punëdhënësve për evidentimin e aspekteve të caktuara të marrëdhënieve me punëmarrësit, por që ky dokumentacion i brendshëm nuk e bën ligjërisht të vlefshme marrëdhënien e punës dhe as të ardhurat prej saj.

38.11 Nga ana tjetër, periudha kur marrëdhënia e punës së bashkëshortit regjistrohet dhe bëhet e ligjshme ka filluar në korrik 2003 e në vijim, pra 21 vjet më parë (edhe pse është përtej afatit 10-vjeçar të ruajtjes së dokumenteve), por edhe në këtë periudhë janë regjistruar dhe dokumentuar vetëm vlerat e pagave dhe jo vlerat e dietave.

38.12 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për t’u aplikuar pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për pamundësinë objektive të subjektit që të paraqesë më shumë prova për të provuar të ardhurat e bashkëshortit nga puna, do të konsiderohej nëse kjo pamundësi do të provohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm jo vetëm nga punëdhënësit, por edhe nga organet përkatëse që administrojnë dokumentacionin në lidhje me punësimin dhe detyrimet që rrjedhin prej tij. Gjatë hetimit administrativ dhe në prapësime, subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion që të provojë këtë pamundësi. Për këto arsye, pika 2 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 nuk mund të aplikohet për këtë rast.

38.13 Edhe sikur të konsiderohet se për dietat e përfituara nuk është ruajtur dokumentacion për shkak të periudhës së gjatë që ka kaluar dhe për shkak të informalitetit në marrëdhëniet e punësimit, nëse do të mbahet parasysh që subjekti ka pasur detyrimin për deklaram që në vitin

mbështetur mbi një dispozitë ligjore nga organi kompetent, vlerësohet se është një dokument zyrtar në kuptim të nenit 49, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, i cili për më tepër është administruar nga Komisioni zyrtarisht prej institucionit që e ka hartuar atë në funksion të procesit të rivlerësimit. Kolegji vlerëson me rëndësi të nënvizojë faktin se përpilimi i këtij dokumenti zyrtar jo vetëm që është bërë nga organi kompetent në përputhje me procedurën dhe formën e kërkuar prej ligjit, por ai daton në një kohë të largët e pa lidhje me kontekstin e procesit të rivlerësimit e në zbatim të tagrave ligjorë të tij, duke krijuar bindjen se të dhënat e përfuara në këtë dokument, nëpërmjet shpjegimeve të dhëna nga subjekti, kanë shëruar pasaktësisht në deklaram të subjektit të rivlerësimit në funksion të zbatimit të ligjit nr. 9049/2003, në mënyrë autonome nga procesi i rivlerësimit”.

2003 dhe që çdo deklaram pasurie duhet të provohet me dokumentacionin përkatës, subjekti me cilësinë edhe të personit ligjzbatues, duhej të tregonte kujdesin e shtuar për të kërkuar dokumentacionin e nevojshëm me të cilin do të provonte përfitimin e dietave si të ardhura të ligjshme të bashkëshortit të saj. Fakti që punësimi “në të zezë” i bashkëshortit të subjektit është deklaruar në deklaratën *Vetting*, provon se subjekti për vlerat e të ardhurave (paga + dieta) që ka deklaruar në deklaramet periodike, e ka ditur dhe është pajtuar me punësimet dhe të ardhurat e paligjshme të bashkëshortit.

38.14 Nga deklaramet në DIPP-në e viteve 2005 – 2016 rezulton se janë deklaruar vlera vjetore të dietave nga 2-4 herë më të larta se vlera vjetore e pagave që subjekti pretendon se ka përfituar bashkëshorti i saj, çka krijon dyshimin se vlera e pagës që ka marrë bashkëshorti për punën e kryer është më e madhe dhe nuk është deklaruar e plotë, por i është dhënë atij me emërtimin “dieta”, duke e përforcuar akoma më tepër situatën e paligjshmërisë së këtyre të ardhurave.

38.15 Këto fakte tregojnë se punëdhënësi dhe punëmarrësi mund të jenë dakordësuar që të mos regjistrohen dhe deklarohen vlerat e dietave që pretendohet se janë përfituar nga bashkëshorti i subjektit. Ky veprim i bën të ardhurat nga këto dieta të paligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pamatshme.

38.16 Pretendimi që ngriti subjekti në prapësime se ILDKPKI-ja i ka përfshirë në analizë financiare të ardhurat e siguruara nga puna e bashkëshortit të saj dhe nuk ka konstatuar problematika për pasurinë në raportin që ka hartuar, sipas Komisionit nuk është një argument bindës për të ndikuar në gjykimin lidhur me vlerësimin e këtyre të ardhurave. Komisioni, sipas dispozitave të ligjit nr. 84/2016, ka përcaktuar kompetencën e Komisionit për të hetuar në mënyrë të pavarur, duke u orientuar nga raporti i ILDKPKI-së, i cili nuk është detyrues për përfundimin e procesit të rivlerësimit që kryen Komisioni.

38.17 Gjatë seancës dëgjimore, subjekti herë mbajti qëndrimin se dietat janë “pagesa” për punën e kryer dhe sipas ligjit të kohës për këto pagesa nuk kishte detyrim për pagimin e tatimeve, herë citonte se janë “dieta”, duke treguar kështu paqëndrueshmëri në shpjegimet e saj.

38.18 Në lidhje me dietat, Komisioni mban në konsideratë edhe praktikën e tij dhe të Kolegjit⁹⁶, sipas së cilës dieta nuk mund të konsiderohen si e ardhur, pasi është kompensim për një shpenzim të kryer më parë dhe kanë destinacion mbulimin e shpenzimeve për nevoja ushqimore, transporti apo fjetje, të kryera gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës.

38.19 Në përfundim, vlerësimi i Komisioni mbetet i njëjtë, duke mos i përfshirë dietat si “të ardhura” në analizën financiare, por duke reduktuar shpenzimet e jetesës së bashkëshortit të subjektit për kohën e qëndrimit në udhëtime pune.

Të ardhurat e deklaruara nga XH.B, vajza e subjektit të rivlerësimit

39. Të ardhurat në vlerën 316,360 lekë nga puna si disenjatore reklame në subjektin “E.B”, në periudhën 15.8.2016 – 31.12.2016

⁹⁶ Paragrafi 26.9 i vendimit nr. 12, datë 12.05.2021, të Kolegjit (SR A.M.); paragrafi 28.1 i vendimit nr. 18, datë 12.7.2021, të Kolegjit (SR R. L.); paragrafët 37.1, 37.3 të vendimit nr. 54, datë 19.12.2023 (SR K. H.); vendimi nr. 01/2021 (SR A. S.); paragrafi 15 i vendimit nr. 01/2020 (SR A. B.); paragrafi 61 i vendimit nr. 04/2020 (SR A. D.).

Të ardhurat në vlerën 127,872 lekë nga puna si asistent pedagogje pranë Universitetit P, me adresë rruga “**”, autostrada Tiranë-Durrës, km ***, Kashar, Tiranë, për periudhën 12.10.2015 – 17.6.2016**

39.1 Referuar dokumentacionit⁹⁷ që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* dhe dokumentacionit⁹⁸ të administruar nga Komisioni, rezultoi se XH.B, e punësuar si disenjatore reklame pranë subjektit “E.B” në periudhën 15.8.2016 – 31.12.2016, ka përfituar pagat neto në vlerën totale 312,360 lekë dhe janë paguar kontributet shoqërore-shëndetësore. Gjithashtu, ka punuar asistente pedagogje pranë Universitetit P në periudhën 12.10.2015 – 17.6.2016, duke përfituar të ardhura nga paga në shumën 127,872 lekë dhe janë paguar kontributet shoqërore-shëndetësore.

39.2 Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga paga në shumat 316,360 lekë dhe 127,872 lekë.

39.3 Në përfundim, rezultoi se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit përputhen me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.

40. ANALIZA FINANCIARE 2003 – 2016

40.1 Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

40.2 Në konkludim të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit rezulton me pamundësi financiare me vlerë negative -16,656,591 lekë, për periudhën 2003 – 2016 dhe vlerë negative -1,510,403 lekë, për periudhën 1992 – 2002, para deklaratimit të parë periodik.

40.3 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

40.4 Për të kundërshtuar rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit kërkoi që të përfshihen në analizë financiare: (i) gjendja *cash*, pasi përfshirja e saj në analizën financiare përputhet me qëndrimin e Kolegjit në vendimin nr. 37/2021, se pasaktësitë në deklaratimet periodike të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive nuk mund të konsiderohen si shkaqe për të ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi; (ii) të ardhurat e siguruar prej bashkëshortit nga puna dhe dietat si shofer.

40.5 Subjekti kërkoi që të zbatohet parimi i proporcionalitetit, i cili është zbatuar gjerësisht në praktikën e Komisionit, sikurse në vendimet e formës së prerë të paankimuara⁹⁹ nr. 188, datë

⁹⁷ Vërtetim datë 11.1.2017 nga subjekti “E.B”; vërtetim nr. ***, datë 24.1.2017, nga Universiteti P.

⁹⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 2.3.2021, nga ISSH-ja; shkresa nr. *** prot., datë 4.3.2021, nga DPT-ja.

⁹⁹ Vendim nr. 188, datë 24.7.2019: “...trupit gjykues çmon se bilanci përfundimtar, i konstatuar në vlerën negative prej 1.170.217 lekësh, në këtë rast – duke pasur parasysh edhe funksionin e mbuluar në të kaluarën profesionale nga subjekti – në vetvete dhe në tërësinë e fakteve dhe rrethanave, nuk vlerësohet shkak i mjaftueshëm që të pasjellë zbatimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi për sa i përket përlllogaritjeve dhe rezultateve financiare – të cilat kryhen nëpërmjet një analize të thelluar, strikte dhe gjithëpërfshirëse – ato duhet të vlerësohen në harmoni me kuadrin e plotë të rrethanave dhe provave të arritura, si dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit”.

24.7.2019, nr. 152, datë 7.6.2019 dhe nr. 218, datë 10.12.2019, si dhe në praktikën e Kolegjit¹⁰⁰ me vendimet nr. 2, datë 2.2.2023 dhe nr. 19, datë 10.6.2022.

40.6 Subjekti shpjegoi se në rreth 30 vite punë familja e saj disponon aktualisht si pasuri dy apartamente dhe një automjet. Të ardhurat dhe pasuria e krijuar me të ardhura të ligjshme janë dokumentuar mjaftueshëm sipas mundësive që ka pasur subjekti për të ruajtur dokumentacionin ligjor dhe financiar për një periudhë më shumë se 34 vite, e cila është jashtë periudhës maksimale deri në 10 vjet për ruajtjen e dokumentacionit, referuar ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare (në fuqi deri në 2018-ën), nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare (në fuqi nga viti 2019), nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

40.7 Subjekti depozitoi bashkëlidhur prapësimeve analizën financiare për periudhën 2004 – 2019, të përgatitur nga eksperti kontabël. Sipas kësaj analize financiare, të ardhurat e ligjshme të familjes kanë qenë më të mëdha se shpenzimet dhe kanë mbuluar të gjitha shpenzimet për jetesë, investim/blerje pasuri të luajtshme e të paluajtshme, duke mos pasur kështu mungesë të ardhurash të ligjshme.

40.8 Nga kjo analizë financiare konfirmohet se subjekti raportues ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar *cash* edhe shtesa të tjera likuiditetesh, me të cilat janë krijuar pasuri dhe janë mbuluar shpenzimet gjatë periudhës 2005 – 2019.

40.9 Në përfundim, subjekti shpjegoi se:

Vendim nr. 152, datë 7.6.2019 (pika 92): “Komisioni vlerëson se pasaktësia e konstatuar për mosdeklarimin në vitin 2015 të shumës *cash* prej 10.000 euro, gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, nuk cenon figurën e prokurorit dhe nuk ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia”.
Vendim nr. 218, datë 10.12.2019: “Subjekti në analizën financiare të realizuar nga Komisioni rezulton me diferencë në vlerën 856.228 lekë (referuar dy momenteve të blerjes së dy pasurive ku subjekti dhe personat e lidhur me të rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme) ...E njëjta logjikë, e bazuar në parimin e proporcionalitetit, vlen dhe duhet të përdoret në analizimin në harmoni të të gjitha kriterëve të këtij procesi rivlerësimi, përfshirë këtu edhe kriterin e pasurisë. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se diferencat e konstatuara në vlerë negative të vogël pas analizës financiare të subjektit nuk mund të çojnë në një përfundim të përgjithshëm mbi mungesën e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk mund të passjellin shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra”.

¹⁰⁰ Vendim nr. 2, datë 2.2.2023 (pika 19.21): “Kolegji vlerësoi mungesën e burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 872.576 lekësh, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe të proporcionalitetit dhe në konsideratë të faktit se kjo vlerë shpërndahet në disa vite në vlera jo domethënëse. Kjo balancë negative nuk u vlerësua se duhet të krijojë një përgjegjësi disiplinore për subjektin e rivlerësimit, për pasojë, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti ka nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016”.
Vendim nr. 19, datë 10.6.2022: “29.13. Në përmbyllje të kontrollit të analizës financiare për vitet 2006, 2009, 2011, 2012, 2014, 2015, të ankmuara nga subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga diferenca e pajustificuar prej (-) 2.131.883 lekësh, që i ka rezultuar Komisionit, dhe ndryshe nga pretendimi i subjektit të rivlerësimit në vlerën prej (-) 692.656 lekësh, trupit gjykues të Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kishin mungesë të burimeve të ligjshme në vlerën prej (-) 1.272.570 lekësh. 29.14. Lidhur me analizën financiare për periudhën 2006 – 2016, trupi gjykues, bazuar në analizën financiare të kryer në Kolegji, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, vlerëson se bilanci negativ rezulton të jetë konsiderueshëm më i vogël se sa ai i konstatuar nga Komisioni. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, por bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, kjo problematikë nuk mund të shërbejë për t’u kualifikuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. 30. Trupi gjykues, bazuar në sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016”.

- Ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të lidhur.
- Ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive.
- Nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim.
- Pasuria neto në pronësinë e saj e krijuar gjatë periudhës së rivlerësimit në raport me të ardhurat është disa herë më e vogël. Ndërkohë që Kushtetuta, në nenin D të saj, parashikon si masë disiplinore shkarkimi rastin kur subjekti ka një pasuri më tepër se dyfishi i të ardhurave të ligjshme.

40.10 Sa më sipër, ka provuar se sipas nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

Vlerësimi i Komisionit

40.11 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se në lidhje me pretendimin e subjektit për përfshirjen e gjendjes *cash* në analizën financiare, vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi në analizën financiare të dërguar në rezultatet e hetimit gjendja *cash* është përfshirë dhe është pasqyruar sipas deklarimeve periodike të subjektit dhe personit të lidhur. Ajo që është konstatuar nga Komisioni është pikërisht mungesa e burimeve të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash* dhe shtesa të tjera likuiditetesh, për të krijuar pasuri dhe për të mbuluar shpenzimet për shkak të balancave negative, duke cenuar në këtë mënyrë ligjshmërinë e likuiditeteve.

40.12 Sikurse Komisioni analizoi gjatë hetimit administrativ dhe sikurse vlerësoi në përfundim në lidhje me të ardhurat nga puna dhe dietat e bashkëshortit të subjektit, nuk u provua ligjshmëria e këtyre të ardhurave dhe as vlera fikse e tyre. Si rrjedhojë, Komisioni nuk mund të përfshijë në analizë financiare as vlerën e gjendjes *cash* për periudhën 2004 – 2019.

40.13 Analiza financiare e paraqitur nga subjekti në prapësime nuk është bindëse për Komisionin. Komisioni konstatoi se analiza financiare e përpiluar nga eksperti kontabël është kryer bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike dhe jo në dokumentacion ligjor provues, duke e bërë në këtë mënyrë rezultatit e arritur të cenueshëm dhe jo të besueshëm.

40.14 Nga verifikimi i deklaratave periodike me dokumentacionin ligjor provues të depozituar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, si dhe dokumentacionin e depozituar gjatë hetimit dhe administruar nga Komisioni, ka rezultuar se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për sa i përket të ardhurave nga punësimi kryesisht janë deklaruar në vlera më të mëdha, ndryshe nga sa provohet në vërtetimet e pagave për të ardhurat e përfituara për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore, të cilat në këto dokumente rezultojnë në vlera më të vogla, vlera këto të pasqyruara në analizën financiare të dërguar me rezultatet e hetimit. Në analizën e depozituar në prapësime nga subjekti i rivlerësimit janë përfshirë edhe të ardhurat e bashkëshortit nga dietat, ndërkohë që subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor përfitimin e tyre dhe pagesën e detyrimeve tatimore për to.

40.15 Gjithashtu, Komisioni konstatoi se në analizën financiare të kryer nga eksperti, vlera e likuiditeteve bankare nuk është pasqyruar saktë, pasi nuk përputhet me dokumentacionin bankar të administruar nga bankat e nivelit të dytë. Konkretisht, në vitin 2011 është mbartur si gjendje depozita 5,000 euro¹⁰¹, edhe pse ajo rezulton e mbyllur më 3.1.2011. Ndër të tjera, në vlerën totale të likuiditeteve bankare nuk janë përfshirë llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit. Në analizën e kryer nga eksperti nuk janë përfshirë shpenzimet e udhëtimit, me përjashtim të shumave të deklaruara në DIPP-në e viteve 2012, 2013, 2015 dhe 2016, edhe pse nga sistemi TIMS ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë udhëtuar edhe në vitet e tjera të deklarimit. Subjekti në prapësime nuk ka kundërshtuar shumat e llogaritura nga Komisioni dhe nuk ka dhënë asnjë argument lidhur me mospërfshirjen në analizën e ekspertit të shpenzimeve të konstatuara nga Komisioni.

40.16 Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe lidhur me shpenzimet e tjera, si shpenzime shkollimi, shpenzime qiraje, mobilimi etj., të kryera në vitet përkatëse dhe të llogaritura nga Komisioni/të rezultuara nga dokumentacioni ose nga deklarimi në pyetësorë, shpenzime të cilat subjekti nuk i ka kundërshtuar për vlerat e pasqyruara në rezultate, por thjesht i ka përjashtuar nga analiza e paraqitur nga ekspertja për shkak se kjo analizë është hartuar vetëm mbi bazën e deklarimeve periodike të subjektit dhe personit të lidhur.

40.17 Në analizën financiare të rishikuar, Komisioni e ka konsideruar në vlerën 64,000 euro pasurinë apartament me sip. 82 m², me vendndodhje në Vlorë.

40.18 Në përfundim, Komisioni konstaton se edhe analiza financiare e depozituar nga subjekti në cilësinë e provës në prapësime rezulton me balancë negative prej -2,391,270 lekësh, konkretisht në vitet 2004, 2007, 2009 dhe 2011 dhe se balanca pozitive e pretenduar prej saj nuk qëndron.

40.19 Pavarësisht sa më lart, edhe sikur Komisioni të marrë në konsideratë dietat për efekt të analizës financiare, sërish subjekti dhe personat e lidhur nuk do të kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash* dhe shtesa të tjera likuiditetesh, për të krijuar pasuri dhe për të mbuluar shpenzimet gjatë periudhës së punësimit të subjektit si prokurore, pasi balanca negative do të rezultonte në shumën 9,880,244 lekë, shumë kjo e konsiderueshme për të ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, në masën e shkarkimit nga detyra.

40.20 Vlera e pasurive dhe shpenzimeve të tjera të subjektit dhe personave të lidhur me të është në vlerë disa herë më të madhe sesa vlera e të ardhurave, prandaj nuk mund të zbatohet parimi i proporcionalitetit, qoftë edhe duke iu referuar rasteve të praktikës së Komisionit apo Kolegjit të përmendura nga subjekti në prapësime.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar neneve Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme,

¹⁰¹ Shihni depozitën bankare në ISP Bank në emër të subjektit, me nr. ***, e vlefshme për periudhën 10.12.2007 – 3.1.2011.

si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, çmon se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivelin kualifikues, pasi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, ka bërë deklaram të rremë në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë dhe deklaram fiktiv të çmimit të blerjes dhe shitjes së pasurisë, duke cenuar me këto veprime besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe si të tilla, këto veprime bazuar në nenin 61, pikat 5 e 3 të ligjit nr. 84/2016 përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1/a të nenit 58, pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Rajmonda Berisha (Kopaçi), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr.84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 3.7.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE

Kryesuese

Alma FASKAJ

Relatore

Pamela QIRKO

Anëtare